До донесувањето на решението за преведување од ставот 1 на овој член, корисникот продолжува да го користи правото од заштита на децата согласно со прописите што биле во сила до денот на влегувањето во сила на овој закон.

Правата за заштита на децата предвидени со овој закон ќе започнат да се исплатуваат наредниот месец по влегувањето во сила на овој закон, а за претходниот месец.

Член 97

Центарот за социјална работа по службена должност на корисниците на посебен додаток ќе им донесе решение за користење на правото на посебен додаток без поднесување на барање, согласно со постојниот наод за оцена и мислење на видот и степенот на попреченост од стручен орган и решението за видот и степенот на попреченост врз основа на кои е стекнато правото.

Член 98

Вработените со завршено вишо образование VI/1 степен, со стекнати 180 кредити по ЕКТС и со средно четиригодишно образование - даватели на јавни услуги, кои на денот на влегувањето во сила на овој закон работеле на работни места како воспитувачи/стручни соработници/негователи и ги исполнувале условите за соодветното работно место согласно со Законот за заштита на децата („Службен весник на Република Македонија“ број 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 и 198/18), можат и понатаму да ја вршат работата на работното место на кое се затечени со влегувањето во сила на овој закон. Истите ќе можат да ја обновуваат/продолжуваат стекнатата соодветна лиценца за работа согласно со овој закон.

На воспитувачите со завршено вишо образование VI/1 степен од ставот 1 на овој член, кои до денот на влегувањето во сила на овој закон работеле на работни места како воспитувачи за кои ги исполнувале условите согласно со Законот за заштита на децата („Службен весник на Република Македонија“ број 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 и 198/18), делот на платата за степен на образование за соодветното ниво на работно место-воспитувач ќе се вреднува во износ на бод како и за ниво на воспитувач, ниво на квалификации VIA, 240 кредити според ЕКТС или завршен VII/1 степен согласно со овој закон.

Член 99

Подзаконските акти предвидени со овој закон се донесуваат во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 100

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Северна Македонија да утврди пречистен текст на Законот за заштита на децата.

Член 101

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

---

## L I GJ
## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të fëmijëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18) në nenin 6 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

„Të drejtat për mbrojtje të fëmijëve, në kuptim të këtij ligji, janë:

1) shtesë e fëmijëve;

2) shtesë e veçantë;

3) ndihmë e njëhershme në para për të sapolindur;

4) shtesë prindërore për fëmijë;

5) shtesë për arsim;

6) participim.".

Neni 2

Në nenin 11 paragrafi (2) shlyhet.

Neni 3

Në nenin 12 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitet gjinor, përkatësisë së grupit të margjinalizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjionit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqëror ose cilësdo bazë tjetër.".

Neni 4

Neni 14 ndryshohet si vijon:

"(1) Diskriminim i drejtpërdrejtë ekziston kur me kërkuesin ose shfrytëzuesin e mbrojtjes së fëmijëve veprohet, është vepruar ose do të veprohet në mënyrë më të pavolitshme në lidhje me person ose grup tjetër në situatë faktike krahasimtare ose të ngjashme, në bazë diskriminuese.

(2) Diskriminim indirekt ekziston kur kërkuesi ose shfrytëzuesi i mbrojtjes së fëmijëve vihet në pozitë më të pavolitshme në krahasim me persona ose grup të personave tjerë, nëpërmjet të gjoja rregullave neutrale, dispozitave, kritereve, programeve ose praktikave, përveç kur dalin nga qëllimi legjitim, ndërsa mjetet për arritje të atij qëllimi janë proporcionale, përkatësisht janë adekuate dhe të domosdoshme.".

Neni 5

Në nenin 15 në paragrafin (1) fjalët: “nenet 13 dhe 14" zëvendësohen me fjalët: “neni 12 paragrafi (1)”.

Neni 6

Në nenin 16 në paragrafin (5) fjalët: “në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj" zëvendësohen me fjalët: “me të cilën udhëheq person i cili i plotëson kushtet në pajtim me ligj, i emëruar nga person përgjegjës i institucionit të lartë arsimor".

Në paragrafin (6) fjalët: “në pajtim me kushtet të përcaktuara me ligj" zëvendësohen me fjalët: “me të cilën udhëheq person i cili i plotëson kushtet në pajtim me këtë ligj, i emëruar nga person përgjegjës i shkollës private".

Neni 7

Neni 22 ndryshohet si vijon:

"(1) E drejta për shtesë fëmijërore sigurohet për fëmijë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili jeton në ekonomi familjare me vendbanim të përhershëm të jetesës në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nëse ekonomia familjare nuk posedon pronë dhe të drejta pronësore nga të cilat mund të mbahet.

(2) E drejta e shtesës fëmijërore sigurohet edhe për fëmijë nga ekonomi familjare e cila ka realizuar përkatësisht shfrytëzon të drejtë të ndihmës së garantuar minimale në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.

(3) Të drejtën për shtesë fëmijërore mund ta realizojë një nga prindërit e fëmijës, kujdestari ose personi të cilit me aktvendim të qendrës kompetente për punës sociale fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim me kushte të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Shfrytëzuesi i të drejtës të shtesës fëmijërore duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.".

Neni 8

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Shtetasi i huaj i cili ka vendbanim dhe qëndrim të rregulluar të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligj, mund të realizojë të drejtë të shtesës fëmijërore për fëmijë në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.".

Neni 9

Neni 24 ndryshohet si vijon:

"E drejta për shtesë fëmijërore realizohet në varësi nga gjendja materiale e ekonomisë familjare.".

Neni 10

Neni 25 ndryshohet si vijon:

"E drejta e shtesës fëmijërore sigurohet për fëmijë deri në mbushjen e 18 vjetëve.".

Neni 11

Në nenin 26 paragrafi (2) në alinenë 2 presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Në alinenë 3 lidhëza "dhe" zëvendësohet me pikë.

Alineja 4 shlyhet.

Neni 12

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"(1) Të drejtë për shtesë fëmijërore ka fëmija në familje të hyrat e përgjithshme mesatare të së cilës në muaj të realizuar në tre muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës dhe gjatë shfrytëzimit të të drejtës pas të gjitha bazave të të gjithë anëtarët e ekonomisë familjare janë në lartësi deri në pragun për qasje të të drejtës të shtesës fëmijërore, i cili është vënë në 6000 denarë, ndërsa i cili zmadhohet për çdo anëtar të ekonomisë familjare për koeficient të shkallës ekuivalente, ndërsa më së shumti për gjithsej tetë anëtarë në ekonomi familjare, edhe atë për:

- anëtari i dytë për koeficient prej 0,5,
- anëtari i tretë për koeficient prej 0,4,
- anëtari i katërt për koeficient prej 0,4,
- anëtari i pestë për koeficient prej 0,2,
- anëtari i gjashtë për koeficient prej 0,1,
- anëtari i shtatë për koeficient prej 0,1 dhe
- anëtari i tetë për koeficient prej 0,1.

(2) Shkalla ekuivalente nga paragrafi (1) të këtij neni zmadhohet në mënyrë plotësuese për koeficient prej 1.2 për prind të vetëm.

(3) Gjatë përcaktimit të lartësisë së pragut për qasje të të drejtës të shtesës fëmijërore, si anëtar i ekonomisë familjare ose familjes nuk konsiderohet person i cili është:

- në vuajtje të dënimit me burg më gjatë se 30 ditë,
- me aktvendim të qendrës për punë sociale është vendosur në institucion për mbrojtje sociale jashtëfamiljare, ose është vendosur në institucion shëndetësor ose institucion tjetër për periudhë deri sa zgjat vendosja dhe
- kryerës i dhunës familjare.

(4) Të hyrat dhe prona e personit nga paragrafi (3) alinetë 3 të këtij neni, nuk llogariten gjatë realizimit të të drejtës së shtesës fëmijërore.

(5) Kur ekonomisë familjare do t'i pushojë e drejta e ndihmës së garantuar minimale në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, qendra për punë sociale me detyrë zyrtare rishqyrton nëse janë plotësuar kushtet për vazhdimin e shfrytëzimit të së drejtës së shtesës për fëmijë.”.

Neni 13

Neni 28 ndryshohet si vijon:

"(1) Ekonomia familjare në kuptim të këtij ligji është ekonomi familjare me një anëtar ose bashkësi e anëtarëve të familjes, si dhe farefis tjerë ndërmjet të cilëve nuk ekziston detyrim ligjor për mbajtje të ndërsjellë, të cilët bashkërisht jetojnë, kontribuojnë, ekonomizojnë dhe shpenzojnë.

(2) Familjen në kuptim të këtij ligji e përbëjnë bashkëshortët martesor, përkatësisht jashtëmartesor, prind i vetëm, fëmijë të lindur në martesë, jashtë martese ose të adoptuar, të birësuar, nipa pa prindër të marrë në përkujdesje dhe vëllezër dhe motra të mitura (nëse nuk kanë prindër dhe janë pa mjete për ekzistim), të cilët përbëjnë bashkësi të jetesës, ekonomizimit dhe shpenzimit.

(3) Prind i vetëm  i fëmijës për të cilin realizohet e drejta e shtesës për fëmijë dhe/ose  e drejat shtesës për arsim, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet prindi:

- i fëmijës që e mban, nëse njëri prind ka vdekur;
- i fëmijës i cili pas vdekjes së njërit prind, e ka realizuar të drejtën e pensionit familjar, e prindi tjetër është në marrëdhënie pune;
- i fëmijës nga martesa e shkurorëzuar nëse prindi te i cili fëmija jeton nuk jetën në bashkësi martesore, përkatësisht jashtë martesore;
- i fëmijës të cilit njëri prind nuk i njihet dhe
- i fëmijës të cilit njëri prind evidentohet si si zhdukur.”.

Neni 14

Neni 29 shlyhet.

Neni 15

Në nenin 30 alineja 1 ndryshohet si vijon:

„- fëmijë i vendosur në institucion për mbrojtje sociale ose institucion tjetër me aktvendim të qendrës për punës sociale dhe“.

Neni 16

Neni 31 ndryshohet si vijon:

"(1) Lartësia e shtesës fëmijërore varet nga numri i fëmijëve në familje dhe mosha e fëmijëve.

(2) Nëse në familje ka fëmijë në moshë shkollore në pajtim me ligj, lartësia e shtesës fëmijërore për një fëmijë është 1.000 denarë në muaj, ndërsa për dy dhe më shumë fëmijë në familje është 1.600 denarë në muaj për të gjithë fëmijët.

(3) Nëse në familje ka fëmijë i cili nuk është në moshë shkollore në pajtim me ligjin, lartësia e shtesës fëmijërore për një fëmijë është 1.200 denarë në muaj, ndërsa për dy dhe më shumë fëmijë në familje është 1.900 denarë në muaj për të gjithë fëmijët.

(4) Nëse në familje ka dy ose më shumë fëmijë, të cilët nuk janë të gjithë në moshë shkollore, lartësia e shtesës fëmijërore për të gjithë fëmijët është 1.600 denarë në muaj.

(5) Lartësia e shtesës fëmijërore nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak të shpallura nga Enti shtetëror për statistikë në janar për vitin rrjedhës.

(6) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës fëmijërore.".

Neni 17

Në nenin 34 në paragrafin (1) fjalët: “përkujdesje institucionale në barrë të shtetit" zëvendësohen me fjalët: “i vendosur në institucion për mbrojtje sociale jashtëfamiljare ose institucion tjetër me aktvendim të qendrës për punës sociale".

Neni 18

Në nenin 35 në paragrafin (3) fjalët: “ndihmë sociale në para dhe ndihmë të përhershme në para" zëvendësohen me fjalët: “ndihmë të garantuar minimale".

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5), si vijon:

(5) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës së veçantë nga paragrafi (1), (2) dhe (3) të këtij neni.".

Neni 19

Neni 36 ndryshohet si vijon:

"(1) Ndihma e njëhershme në para për të sapolindur sigurohet për familje për fëmijë të sapolindur të parë dhe të dytë.

(2) Si fëmijë i parë dhe i dytë i sapolindur konsiderohet fëmijë i cili është i pari dhe i dyti i lindur i gjallë sipas rendit të lindjes të nënës, i cili rend përcaktohet në mënyrë të njëjtë kur nëna do të lind më shumë fëmijë përnjëherë.

(3) Si fëmijë i sapolindur i parë,  dhe i dytë do të konsiderohen edhe fëmijët e adoptuar, në moshë deri në një vit, nëse nëna nuk ka fëmijë të sapolindur në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni.".

Neni 20

Neni 37 ndryshohet si vijon:

"(1) Të drejtë për ndihmë në ndihmë të njëhershme në para për fëmijë të sapolindur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka një nga prindërit, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me vend të përhershëm të banimit prej së paku 12 muaj pa ndërprerë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në ditën e lindjes së fëmijës.

(2) Lartësia e ndihmës së njëhershme në para për të sapolindur të parë është 5.000 denarë.

(3) Lartësia e ndihmës së njëhershme në para për të sapolindur të dytë është 20.000 denarë.

(4) Lartësia e ndihmës në para të njëhershme nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak të shpallura nga Enti shteteror për statistikë në janar për vitin rrjedhës.

(5) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës së njëhershme nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.".

Neni 21

Në nenin 38 në paragrafin (2) fjalët: “Republikës së Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Pas paragrafit (2) shtohet paragrafi i ri (3), si vijon:

“(3) E drejta nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet nëse të hyrat e përgjithshme mesatare të familjes së nënës në të gjitha bazat në tre muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës për realizim të shfrytëzimit të së drejtës si dhe gjatë shfrytëzimit të së drejtës janë më të ulta se lartësia e rrogës minimale neto të përcaktuar për vitin paraprak.”.

Paragrafët (3), (4) dhe (5), bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Në paragrafin (6) që bëhet paragraf (7), numri (5) zëvendësohet me numrin (6).

Paragrafi (7) bëhet paragraf (8).

Në paragrafin (8), që bëhet paragraf (9), numri (7) zëvendësohet me numrin (8).

Në paragrafin (9), që bëhet paragraf (10), numri (8) zëvendësohet me numrin (9).

Neni 22

Neni 39-a ndryshohet si vijon:

“Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës prindërore për fëmijën e tretë nga neni 39 i këtij ligji .".

Neni 23

Pas nenit 39-a, shtohet titulli i ri “5. Shtesa për arsim” dhe shtatë nene të reja: 39-b, 39-v, 39-g, 39-d, 39-gj, 39-e dhe 39-zh, si vijojnë:

“5. Shtesa për arsim

Neni 39-b

"(1) Shtesë për arsim sigurohet për shkak të mbulimit të një pjese të shpenzimeve të ekonomisë familjare të lidhura me arsimin e fëmijëve.

(2) Të drejtë për shtesë për arsim ka ekonomia familjare me fëmijë i cili është në shkollim të rregullt në arsim fillor ose të mesëm në shkollë në Republikën e Maqedonisë së Veriut të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të hyrat mesatare mujore të të cilës të realizuara në tre muajt e fundit para parashtrimit të kërkesës dhe gjashtë shfrytëzimit të të drejtës sipas të gjitha bazave të të gjithë anëtarëve në ekonomi familjare janë në lartësi të pragut për qasje të të drejtës në shtesë për arsim, i cili është i vendosur në 6000 denarë, ndërsa e cila zmadhohet për çdo anëtarë të ekonomisë familjare për koeficient të shkallës ekuivalente, ndërsa më së shumti për gjithsej tetë anëtarë në ekonomi familjare, edhe atë për:

- anëtari i dytë për koeficient prej 0,5,
- anëtari i tretë për koeficient prej 0,4,
- anëtari i katërt për koeficient prej 0,4,
- anëtari i pestë për koeficient prej 0,2,
- anëtari i gjashtë për koeficient prej 0,1,
- anëtari i shtatë për koeficient prej 0,1 dhe
- anëtari i tetë për koeficient prej 0,1.

(3) Shkalla ekuivalente nga paragrafi (2) i këtij neni zmadhohet në mënyrë plotësuese për koeficient prej 1.2 për prind të vetëm.

(4) Gjatë përcaktimit të lartësisë së pragut për qasje të të drejtës të shtesës për arsim, si anëtar i ekonomisë familjare ose familjes nuk llogaritet person i cili është:

- në vuajtje të dënimit me burg më gjatë se 30 ditë,
- me aktvendim të qendrës për punë sociale është vendosur në institucion për mbrojtje të jashtme sociale të familjes ose është vendosur në institucion shëndetësor ose institucion tjeter për periudhe deri sa zgjat vendosja dhe
- kryerës i dhunës familjare.

(5) Të hyrat dhe prona e personit nga paragrafi (4) alineja 3 të këtij neni, nuk llogariten gjatë realizimit të të drejtës së shtesës për arsim.

(6) Të drejtë për shtesë për arsim ka edhe ekonomia familjare me fëmijë i cili është në shkollim të rregullt në arsim fillor ose të mesëm në shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe regjistrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i cili ka realizuar të drejtë të ndihmës së garantuar minimale në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.

Neni 39-v

"(1) Pagesa e shtesës për arsim, i bëhet nënës, për fëmijë/fëmijët për të cilin paguhet shtesa për arsim për vitin rrjedhës mësimor.

(2) Nëse nënës për shkaqe të arsyeshme nuk mund t'i paguhet shtesa për arsim, pagesa i bëhet babait për fëmijë/fëmijët për të cilin paguhet shtesa për arsim.

(3) Shkaqe të arsyeshme nga paragrafi (2) të këtij neni janë kur nëna:

- nuk është e gjallë,
- e ka braktisur fëmijën,
- është në vuajtje të dënimit me burg,
- është në mjekim të vazhdueshëm të spitalit më shumë se tre muaj,
- është me gjendje shëndetësore të rrezikuar seriozisht,
- është me aftësi të hequr për punë.

Neni 39-g

Të drejtë për shtesë për arsim ka edhe kujdestari i fëmijës pa prindër dhe pa kujdes prindëror i cili nuk është i vendosur në institucion për mbrojtje sociale jashtëfamiljare.

Neni 39-d

(1) Lartësia e shtesës për arsim është 700 denarë në muaj për nxënës në arsimin fillor dhe 1.000 denarë në muaj për nxënës në arsim të mesëm gjatë vitit shkollor.

(2) Lartësia e shtesës për arsim nga paragrafët (1) të këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak të shpallura nga Enti shtetëror për statistikë në janar për vitin rrjedhës.

(3) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës për arsim nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 39-gj

(1) E drejta për shtesë për arsim realizohet nëse fëmija është i regjistruar si nxënës i rregullt në shkollë fillore ose të mesme.

(2) E drejta e shtesë së arsimit shfrytëzohet për fëmijë i cili:

- është i pranishëm në së paku 85% të numrit të përgjithshëm të orëve të realizuara të mësimit dhe
- nuk ka shfrytëzuar shtesë për arsim për vitin e njëjtë shkollor.

(3) E drejta e shtesës për arsim pushon të shfrytëzohet kur:

- fëmija më tej nuk është në moshë të shkollës së mesme në pajtim me ligj,
- fëmija e ka ndërprerë ndjekjen e shkollimit,
- e drejta është realizuar në bazë të të dhënave të pavërteta ose të paplota dhe
- shfrytëzuesi i shtesës për arsim parashtron kërkesë për ndërprerje të të drejtës së shtesës për arsim.

(4) E drejta e shtesës për arsim ndërpritet të shfrytëzohet nga periudha e ardhshme matëse.

(5) Kur ekonomisë familjare do t'i pushojë e drejta e ndihmës së garantuar minimale, qendra për punë sociale me detyrë zyrtare rishqyrton nëse janë plotësuar kushtet për vazhdimin e shfrytëzimit të të drejtës të shtesës për arsim.

Neni 39-e

(1) Pagesa e shtesës për arsim bëhet deri sa fëmija e plotëson kushtin për prani në së paku 85% të numrit të përgjithshëm të orëve të realizuara mësimore për çdo periudhë matëse, të parapara me këtë ligj.

(2) Kontrolli i plotësimit të kushtit për pagesë të shtesës për arsim, bëhet për çdo nga periudhë matëse si në vijim:

- periudhë e parë matëse prej 1 shtator deri në 31 tetor në vitin rrjedhës kalendarik,
- periudhë e dytë matëse prej 1 nëntor deri në 31 dhjetor në vitin rrjedhës kalendarik,
- periudhë e tretë matëse prej 20 janar deri në 31 mars në vitin e ardhshëm kalendarik dhe
- periudhë e katërt matëse prej 1 prill deri në fund të vitit mësimor.

(3) Pagesa e shtesës për arsim bëhet në periudhat matëse si në vijim për pagesë:

- për periudhën e parë matëse gjatë muajit dhjetor në vitin rrjedhës kalendarik,
- për periudhën e dytë matëse gjatë muajit shkurt në vitit e ardhshëm kalendarik,
- për periudhën e tretë matëse gjatë muajit maj në vitin rrjedhës kalendarik dhe
- për periudhën e katërt matëse gjatë muajit korrik në vitin rrjedhës kalendarik.

Neni 39-zh

(1) Shuma vjetore e shtesës për arsim për arsimin fillor në vitin shkollor për fëmijë është 8.400 denarë, ndërsa për arsimin e mesëm në vitin shkollor për fëmijë është 12.000 denarë.

(2) Pagesa e shtesës për arsim bëhet në katër shuma të barabarta nga 2.100 denarë për shfrytëzuesin e të drejtës të shtesës për arsim për fëmijë në arsimin fillor, ndërsa nga 3.000 denarë për shfrytëzuesin të të drejtës së shtesës për arsim për fëmijë në arsimin e mesëm, pas përfundimit të çdonjërës nga periudhat matëse, të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Në rast nëse ka ankesa të zgjidhura pozitivisht dhe njoftim të vonuar nga ana e shkollave, pagesa bëhet deri në 31 tetor të vitit rrjedhës kalendarik për vitin paraprak mësimor.".

Neni 24

Pas nenit 39-zh shtohet nëntitull i ri "5.1 Shtesa për arsim të personit i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore" dhe dy nene të reja 39-z dhe 39-x, si vijojnë:

"5.1 Shtesa për arsim të personit i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore

Neni 39-z

(1) Personi, i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, ndërsa është nxënës i rregullt në shkollë të mesme ka të drejtë në shtesë për arsim.

(2) Lartësia e shtesës për arsim për personin nga paragrafi (1) të këtij neni është 1.600 denarë në muaj nëse personi shfrytëzon ndihmë të garantuar minimale, përkatësisht 5.600 denarë në muaj nëse personi nuk shfrytëzon ndihmë të garantuar minimale.

(3) Lartësia e shtesës për arsim nga paragrafët (2) të këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti shtetëror për statistikë, në janar për vitin rrjedhës.

(4) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës për arsim nga paragrafi (2) të këtij neni.

Neni 39-x

(1) Të drejtë për shtesë për arsim ka edhe personi i cili deri në moshën e tij 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, ndërsa i cili është i regjistruar si student i rregullt në ndonjë nga universitetet publike të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çdo vit të rregullt studimor, më së voni deri në moshën 26 vjeçare.

(2) Personi nga paragrafi (1) të këtij neni i cili do të regjistrohet në ciklin e dytë të studimeve të magjistraturës ka të drejtë në shtesë për arsim për kohëzgjatjen e studimeve të magjistraturës në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por më së shumti deri në tri vjet nga dita e regjistrimit.

(3) Personit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, shtesa për arsim i pushon nëse e riregjistron vitin studimor, përkatësisht regjistrohet në vitin e njëjtë të studimit në institucion tjetër publik të arsimit të lartë.

(4) E drejta nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund përsëri të realizohet me regjistrimin në vitin e ardhshëm studimor në ciklin e njëjtë të studimeve.

(5) Personi nga paragrafi (1) të këtij neni i cili do të regjistrohet në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës ka të drejtë në shtesë për arsim për kohëzgjatjen e studimeve të doktoraturës në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por më së shumti deri në gjashtë vjet nga dita e regjistrimit.

(6) Personi nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni, një herë në vit te qendra për punë sociale dorëzon vërtetim për regjistrim të rregullt të vitit studimor dhe përmbushje të

detyrimeve nga studimet të magjistraturës ose doktoraturës, në pajtim me statutin e institucionit publik të arsimit të lartë, ndërsa më së voni një muaj pas fillimit të vitit studimor.

(7) Lartësia e shtesës për arsim nga paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij neni është 12.000 denarë në muaj nëse personi shfrytëzon banesë sociale me qira, përkatësisht 24.000 denarë në muaj nëse personi nuk shfrytëzon banesë sociale me qira.

(8) Lartësia e shtesës për arsim nga paragrafi (7) të këtij neni harmonizohet me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të shpallura nga Enti shtetëror për statistikë, në janar për vitin rrjedhës.

(9) Në rast kur nuk ka rritje të shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së shtesës për arsim nga paragrafi (7) të këtij neni.".

Neni 25

Numri “5” para titullit “Participimi” zëvendësohet me numrin “6”.

Neni 26

Neni 40 ndryshohet si vijon:

"(1) Në varësi nga gjendja materiale e familjes sigurohet participim në shpenzimet për përkujdesje dhe edukim dhe pushim dhe rekreacion të fëmijëve në institucion publik për fëmijë.

(2) E drejta e participimit nga paragrafi (1) të këtij neni realizohet për fëmijë të cilit gjendja materiale e familjes është e prishur për shkak të fatkeqësisë së pësuar natyrore (zjarr, përmbytje, tërmet dhe tjetër).

(3) Participimi nga parapari (1) të këtij neni sigurohet në çmimin e shërbimit për fëmijë të cilin e paguan prindi.

(4) Participimi nga paragrafi (1) të këtij neni sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) E drejta e participimit në shpenzimet për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve nga mosha parashkollore sigurohet për prindër të vetëm të cilët janë shfrytëzues të ndihmës së garantuar minimale fëmijët e të cilëve janë përkujdesur në institucion publik për fëmijë - çerdhe të fëmijëve.

(6) Prindi i fëmijës për të cilit realizohet e drejta e participimit nga paragrafi (5) të këtij neni duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vend të përhershëm të banimit prej së paku 12 muaj pandërprerë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në ditën e parashtrimit të kërkesës.

(7) Lartësia e të drejtës nga paragrafi (5) të këtij neni është e barabartë me çmimin e shërbimit në institucionin publik për fëmijë të cilin e paguan prindi.

(8) Participimi nga paragrafi (5) të këtij neni sigurohet nga Buxheti i komunës dhe komuna në qytetin e Shkupit në rajonin e të cilës është selia e institucionit.".

Neni 27

Numri “6” para titullit “Procedura për realizimin e së drejtës për mbrojtje të fëmijëve” zëvendësohet me numrin “7”.

Neni 28

Në nenin 41 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Procedura për realizim të të drejtës për mbrojtje të fëmijës ngrihet pas kërkesës të parashtruar të prindit, përkatësisht kujdestarit të fëmijës.".

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Kërkesa për realizim të të drejtës për mbrojtje të fëmijëve nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji, përveç për të drejtën nga pika 6), me dokumentacion të nevojshëm në shtojcë, parashtrohet te qendra për punë sociale kompetente për rajonin në të cilin parashtruesi i kërkesës ka vendbanim ose vendqëndrim, për ndihmë të njëhershme në para për të sapolindur dhe për shtesë për arsim te qendra kompetente për rajonin në të cilin nëna ka vendbanim ose vendqëndrim, ndërsa për shtesë për arsim të personi i cili deri në moshën e tij 18 vjeçare ka pasur status të fëmije pa prind dhe përkujdesje prindërore te qendra kompetente për rajonin në të cilin personi si parashtruesi i kërkesës ka vendbanim ose vendqëndrim.".

Paragrafët (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (3), (4) dhe (5).

Në paragrafin (7), i cili bëhet paragraf (6), numri "(6)" zëvendësohet me numrin "(5)", ndërsa numri "(5)" zëvendësohet me numrin "(4)".

Në paragrafin (8), i cili behet paragraf (7), numri "(5)" zëvendësohet me numrin "(4)", ndërsa numri "(7)" zëvendësohet me numrin "(6)".

Paragrafi (9) bëhet paragraf (8).

Në paragrafin (10), i cili bëhet paragraf (9), numri "(3)" zëvendësohet me numrin "(2)".

Neni 29

Në nenin 42 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Për kërkesën për realizim të së drejtës nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji, përveç për të drejtën nga pika 6), vendos qendra për punë sociale kompetent për rajonin në të cilin parashtruesi i kërkesës ka vendbanim, përkatësisht vendqëndrim në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, për ndihmë të njëhershme në para për të sapolindur vendos qendra kompetente për rajonin në të cilin nëna ka vendbanim përkatësisht vendqëndrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, për shtesë prindërore për fëmijë vendos qendra kompetente për rajonin në të cilin nëna ka vendbanim të përhershëm në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, për shtesë të arsimit vendos qendra për punë sociale kompetente për rajonin në të cilin nëna ka vendbanim përkatësisht vendqëndrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, e për shtesë të arsimit të personit i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, vendos qendra për punë sociale kompetente për rajonin në të cilin personi ka vendbanim përkatësisht vendqëndrim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.".

Neni 30

Në nenin 43 në paragrafin (1) fjalët: "vërtetim dhe" zëvendësohen me fjalët: "vërtetim ose".

Neni 31

Neni 48 ndryshohet si vijon:

"(1) E drejta e mbrojtjes së fëmijëve realizohet nga dita e parashtrimit të kërkesës, përveç për ndihmë të njëhershme në para për të sapolindur, për shtesë për arsim dhe për shtesë prindërore për fëmijë.

(2) Kërkesa për realizim të të drejtës së ndihmës të njëhershme në para për të sapolindur me dokumentacionin e nevojshëm parashtrohet te qendra kompetente për punë sociale, më së voni deri në mbushjen e tre muaj jetë të fëmijës, ndërsa për fëmijë të adoptuar më së voni deri në tre muaj nga evidentimi i fëmijës së adoptuar në librin e të lindurve.

(3) Kërkesa për realizim të së drejtës për shtesë për arsim me dokumentacion të nevojshëm parashtrohet te qendra kompetente për punë sociale në fillim të vitit mësimor, përkatësisht deri në 1 shtator në vitin rrjedhës përfundimisht me 31 mars të vitit të ardhshëm. Që të realizohet e drejta për shtesë për arsim për periudhë të parë matëse kërkesa duhet të parashtrohet më së voni deri në 15 tetor në vitin rrjedhës. E drejta për shtesë për arsim në varësi nga koha e parashtrimit të kërkesës realizohet nga periudha e ardhshme matëse nga dita e parashtrimit të kërkesës, ndërsa person i cili deri në moshën e tij 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore realizon/shfrytëzon të drejtë të shtesës për arsim në fillim të vitit studimor.

(4) Kërkesa për realizim të së drejtës për shtesë prindërore për fëmijë me dokumentacion të nevojshëm parashtrohet te qendra kompetente për punë sociale, më së voni deri në mbushjen e tre muajve jetë të fëmijës dhe e drejta për shtesë prindërore për fëmijë realizohet nga dita e lindjes së fëmijës.

(5) Radhitja e lindjes së fëmijëve te e drejta për shtesë prindërore për fëmijë përcaktohet sipas numrit të fëmijëve të gjallë të nënës të përcaktuar lidhur me ditën e parashtrimit të kërkesës për realizim të së drejtës për shtesë prindërore për fëmijë, sipas datës dhe orës së lindjes të regjistruar në librin e amzës të të lindurve, radhitje që përcaktiohet në mënyrën e njëjtë edhe në rastet kur nëna do të lindë më shumë fëmijë njëherësh.

(6) E drejta për mbrojtje të fëmijëve pushon me ditën e pushimit të plotësimit të kushteve për shfrytëzim të të drejtës të përcaktuar me këtë ligj.".

Neni 32

Në nenin 49 para fjalës "Shfrytëzuesi" shtohet numri "(1)" dhe fjalët: "1, 2 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "1, 2, 4 dhe 5".

Pas paragrafit (1) shtohen katër paragrafë të rinj (2), (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

"(2) Nëse shfrytëzuesi i të drejtës nga paragrafi (1) të këtij neni nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) i pushon e drejta.

(3) E drejta nga paragrafi (1) të këtij neni pushon edhe në rast kur parashtruesi i kërkesës nga neni 45 të këtij ligji ka dhënë të dhëna të pavërteta.

(4) Qendra për punë sociale me detyrë zyrtare përkohësisht, ndërsa së paku një herë në vit e rishqyrton ekzistimin e fakteve dhe kushtet për fitim dhe shfrytëzim të të drejtës për mbrojtje të fëmijëve dhe nëse përcakton se të njëjtat janë të ndryshuara, miraton aktvendim të ri.

(5) Qendra për punës sociale e përcakton nevojën për realizim dhe shfrytëzim të të drejtës nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji, përveç për të drejtën nga pikat 2) dhe 3), në bazë të kontrollit të bërë të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare të parashtruesit të kërkesës dhe shfrytëzuesi i të drejtës, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.".

Neni 33

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"Qendra kompetente për punë sociale është e obliguar më së voni deri të 5-tin e muajit të dorëzojë te Ministria raport për shfrytëzimin e mjeteve për muajin e fundit dhe kërkesë për mjetet të nevojshme për pagesë të të drejtave nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të këtij ligji, si dhe për shtesë për arsim të personit i cili deri në moshën 18 vjeçare ka pasur status të fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore, për muajin e ardhshëm me numrin e përgjithshëm të fëmijëve dhe familjeve, përkatësisht shfrytëzuesve për të cilët duhet të paguhen të drejtat, ndërsa për shfrytëzues të shtesës për arsim në pajtim me periudhat matëse të përcaktuara në nenin 39-e paragrafi (3) të këtij ligji."

Neni 34

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"Kushtet më të përafërta dhe mënyra e realizmit të të drejtave për mbrojtje të fëmijëve, si dhe përcaktimi i gjendjes të të hyrave, pronës dhe të drejtave pronësore të ekonomisë familjare dhe familjes për të drejtat nga neni 6 paragrafi (1) pikat 1), 4) dhe 5) të këtij ligji, i përcakton ministri.".

Neni 35

Në nenin 60 në paragrafin (7) fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "ministria".

Në paragrafin (8) pas fjalëve: "gjendja e fëmijës" presja zëvendësohet me pikë, ndërsa fjalët deri në fund të fjalisë shlyhen.

Në paragrafin (9) pas fjalës "zhvillimi" shtohen fjalët: "edhe inkluzioni i tyre në grupet edukative për përkujdesje dhe edukim".

Neni 36

Ne nenin 64 paragrafi (3) pika 2) në alinenë 1 pikëpresja zëvendësohet me lidhëzën "dhe".

Pika 3) shlyhet.

Pika 4) bëhet pikë 3).

Në paragrafin (4) fjalët: "me pengesa të lehta në zhvillimin mental ose pengesë trupore" zëvendësohen me fjalët: "me pengesa të lehta përkatësisht mesatare në zhvillimin intelektual dhe/ose pengesë trupore.".

Neni 37

Neni 65 shlyhet.

Neni 38

Në nenin 92 në paragrafin (7) fjala "ministri" zëvendësohet me fjalën "ministria".

Neni 39

Në nenin 110 fjalët: “zgjeron ose" shlyhen.

Neni 40

Në nenin 111 në alinenë 1 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Pas alinesë 1 shtohet aline e re 2, si vijon:

„- themeluesi më së voni në afat prej 60 ditë nga dita e marrjes së vendimit për dhënie të lejes për themelim të institucionit për fëmijë të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk parashtron kërkesë për ushtrim të veprimtarisë nga neni 102 paragrafi (1) të këtij ligji, dhe“.

Neni 41

Pas nenit 114 shtohet nen i ri 114-a, si vijon:

"Neni 114-a

Anëtarëve të bordit drejtues nga neni 114 të këtij ligji mund t'u paguhet kompensim për prani në mbledhjet nëse themeluesi siguron mjete në lartësi që nuk tejkalon shumë prej 1.000 denarë për mbledhje, por jo më shumë se 10.000 denarë në nivel vjetor.".

Neni 42

Në nenin 134 në paragrafin (4) pas fjalës "aftësim", shtohen fjalët: “sistem i pagës,".

Në paragrafin (6) pas fjalëve: “dispozitat nga" shtohen fjalët: “ky ligj,".

Neni 43

Në nenin 135 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Për të punësuarit nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohen këto kategori të vendeve të punës:

- kategoria A - udhëheqësi i objekti,
- kategoria B - punëtorë profesionalë,
- kategoria V - edukatorë,
- kategoria G - bashkëpunëtorë profesionalë,
- kategoria D – përkujdesës/punëtorë ndihmës profesionalë.”.

Neni 44

Neni 136 ndryshohet si vijon:

"(1) Në korniza të kategorisë A përcaktohet ky nivel i vendeve të punës të udhëheqës të objekteve:

- niveli A1 udhëheqës i objektit të institucionit për fëmijë.

(2) Në korniza të kategorisë B përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të punëtorëve profesionalë:

- niveli B1 këshilltar,
- niveli B2 mentor,
- niveli B3 punëtor profesional,
- niveli B4 praktikant.

(3) Në korniza të kategorisë V përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të edukatorëve:

- niveli V1 këshilltar,
- niveli V2 mentor,
- niveli V3 edukator,
- niveli V4 praktikant.

(4) Në korniza të kategorisë G përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të bashkëpunëtorëve profesionalë:

- niveli G1 këshilltar,
- niveli G2 mentor,
- niveli G3 bashkëpunëtor profesional,
- niveli G4 praktikant.

(5) Në korniza të kategorisë D përcaktohen këto nivele të vendeve të punës të punëtorit profesional përkujdesës/ndihmës:

- niveli D1 këshilltar,
- niveli D2 mentor,
- niveli D3 përkujdesës/punëtori profesional ndihmës,
- niveli D4 praktikant.

(6) Të punësuarit nga paragrafi (1) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të veçanta:

- për nivelin A1 me arsim adekuat profesional për të punësuar nga radhët e punëtorëve profesionalë nga niveli B1, B2 dhe B3, përkatësisht nga radhët e edukatorëve nga niveli V1, V2, V3, së paku pesë vjet përvojë pune në institucion, me licencë adekuate për punës për punëtor profesional përkatësisht edukator.

(7) Të punësuarit nga paragrafi (2) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të veçanta:

- për nivelin B1 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor i diplomuar social, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të përfunduar VII1, licencë e vlefshme për punëtor profesional, me së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.
- për nivelin B2 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor i diplomuar social, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të përfunduar VII1, licencë e vlefshme për punëtor profesional, me së paku tre vjet përvojë pune pas diplomimit.
- për nivelin B3 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor i diplomuar social, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të përfunduar VII1, licencë e vlefshme për punëtor profesional, me së paku një vit përvojë pune pas diplomimit në profesion.
- për nivelin B4 - pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor i diplomuar social, defektolog i diplomuar/edukator special dhe rehabilitues, logoped i diplomuar, doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë, me

240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të përfunduar VII1, licencë të vlefshme për punëtor profesional, pa/me përvojë pune.

(8) Të punësuarit nga paragrafi (3) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të veçanta:

- për nivelin V1 - edukator i fëmijëve të moshës mbi dy vjet deri më moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht deri në nisje në shkollë fillore (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkalla VII/1 dhe edukator për qëndrim të fëmijëve në moshën prej gjashtë vjet, përkatësisht nga nisja në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeçare (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkallë VII/1 ose person me studime të përfunduara për mësim klasor VII/1 shkallë dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin V2 - edukator i fëmijëve të moshës mbi dy vjet deri më moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht deri në nisje në shkollë fillore (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkollim të lartë të përfunduar shkalla VII/1 dhe edukator për qëndrim të fëmijëve në moshën prej gjashtë vjet, përkatësisht nga nisja në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeçare (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkallë VII/1 ose person me studime të përfunduara për mësim klasor VII/1 shkallë dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin V3 - edukator i fëmijëve të moshës mbi dy vjet deri më moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht deri në nisje në shkollë fillore (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkalla VII/1 dhe edukator për qëndrim të fëmijëve në moshën prej gjashtë vjet, përkatësisht nga nisja në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeçare (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituarasipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkallë VII/1 ose person me studime të përfunduara për mësim klasor VII/1 shkallë dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator dhe së paku një vit përvojë pune në profesion.

- për nivelin V4 - edukator i fëmijëve të moshës mbi dy vjet deri në moshën gjashtë vjeçare, përkatësisht deri në nisje në shkollë fillore (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkalla VII/1 dhe edukator për qëndrim të fëmijë në moshë prej gjashtë vjet, përkatësisht nga nisja në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeçare (profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijë të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukim parashkollor dhe pedagog i diplomuar), me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim të lartë të përfunduar shkallë VII/1 ose person me studime të përfunduara për mësim klasor VII/1 shkallë dhe të jenë me licencë të vlefshme për edukator, pa/me përvojë pune në profesion.

(9) Të punësuarit nga paragrafi (4) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të veçanta:

- për nivelin G1 - pedagog muzikor, pedagog i diplomuar i arteve, pedagog i diplomuar për edukatë fizike, fakultet i përfunduar i artit muzikor, fakultet për edukatë fizike, sport dhe shëndet, fakultet për arte figurative, profesor i diplomuar për gjuhë të huaj dhe letërsi, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII1 të përfunduar, licencë e vlefshme për bashkëpunëtor profesional, me së paku pesë vjet përvojë pune pas diplomimit në profesion.

- për nivelin G2 -, pedagog muzikor, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar për edukatë fizike, fakultet të përfunduar të artit muzikor, fakultet për edukatë fizike, sport dhe shëndet, fakultet për arte figurative, profesor i diplomuar për gjuhë dhe letërsi të huaj, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII1 të përfunduar, infermiere e përgjithshme, infermiere e diplomuar/teknik mjekësor, infermiere/teknik, infermiere e lartë, me 180 kredi të fituara ose shkallën VI1 të përfunduar, licencë valide për bashkëpunëtor profesional, me së paku tre vjet përvojë pune në profesion pas diplomimit.

- për nivelin G3 - pedagog muzikor, pedagog i diplomuar i artit, pedagog i diplomuar për edukatë fizike, fakultet të përfunduar të artit muzikor, fakultet për edukatë fizike, sport dhe shëndet, fakultet për arte figurative, profesor i diplomuar për gjuhë dhe letërsi të huaj, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII1 të përfunduar,infermiere e përgjithshme, infermiere e diplomuar/teknik mjekësor, infermiere/teknik, infermiere e lartë, me 180 kredi të fituara ose shkallë të përfunduar VI1, licencë valide për bashkëpunëtor profesional, me së paku një vit përvojë pune në profesion pas diplomimit.

- për nivelin G4 - pedagog muzikor, pedagog i diplomuar i arteit, pedagog i diplomuar për edukatë fizike, fakultet i përfunduar i artit muzikor, fakultet për edukatë fizike, sport dhe shëndet, fakultet për arte figurative, profesor i diplomuar për gjuhë dhe letërsi të huaj, me 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VII1 të përfunduar, infermiere e përgjithshme, infermiere e diplomuar/teknik mjekësor, infermiere/teknik, infermiere e lartë, me 180

kredi të fituara ose shkallë VI1 të përfunduar, licencë valide për bashkëpunëtor profesional, pa/me përvojë pune në profesion.

(10) Të punësuarit nga paragrafi (5) të këtij neni duhet t'i plotësojnë këto kushte të veçanta:

- për nivelin D1 - Fakultet për edukatë fizike sport dhe shëndet - studime profesionale për trajnerë sportivë, Shkollë e lartë e mjekësisë - infermiere e përgjithshme, Fakultet i mjekësisë - infermiere/teknikë, logopedë, fizioterapeutë, akushere, me 180 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë VI të përfunduar, licencë valide për kujdestar dhe së paku pesë vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin D2 - shkollë të mesme katërvjeçare: shkollë të mesme të mjekësisë, arsim të mesëm - drejtimi gjimnaz, shkollë të mesme të muzikës, shkollë të mesme të artit figurativ, shkollë të mesme të edukatës fizike, licencë valide për kujdestar dhe së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

- për nivelin D3 - shkollë të mesme katërvjeçare: shkollë të mesme të mjekësisë, arsim të mesëm - drejtimi gjimnaz, shkollë të mesme të muzikës, shkollë të mesme të artit figurativ, shkollë të mesme të edukatës fizike, licencë valide për kujdestar dhe së paku një vit përvojë pune në profesion.

- për nivelin D4 - shkollë të mesme katër vjeçare: shkollë të mesme të mjekësisë, arsim të mesëm - drejtimi gjimnaz, shkollë të mesme të muzikës, shkollë të mesme të artit figurativ, shkollë të mesme të edukatës fizike, licencë valide për kujdestar me/pa përvojë pune.

(11) Për çështje të cilat kanë të bëjnë me klasifikimin, evidencën, punësimin, avancimin, përsosjen dhe aftësimin profesional, matjen e efektit dhe çështje të tjera në lidhje me marrëdhënien e punës të dhënësve të shërbimeve publike në sferën e mbrojtjes së fëmijëve në institucionet publike për fëmijë, zbatohen dispozitat të këtij ligji.".

Neni 45

Pas nenit 136 shtohet nen i ri 136-a, si vijon:

"Neni 136-a

(1) Të punësuarit në institucionet publike për fëmijë, të cilit kryejnë punë ndihmëse-teknike, kanë status të persona ndihmës-teknikë të Grupit IV dhe për ta përcaktohen këto nëngrupe, kategori dhe nivele:

- nëngrupi 1 kategoria A haus - mjeshtër, kopshtar, ndezës i kazanit me avull, amvis-ekonom dhe persona tjerë ndihmës-teknikë për mirëmbajtje të objekteve dhe të pajisjes,

- nëngrupi 2 kategoria A rojtar dhe persona të tjerë ndihmës teknik për sigurim të objekteve dhe pajisjes,

- nëngrupi 3 kategoria A shofer dhe persona tjerë ndihmës-teknikë për transport të personave, ushqimit dhe pajisjes,

- nëngrupi 4 kategoria A kuzhinier dhe persona tjerë ndihmës-teknikë në kuzhinë ose në objekte hotelerie dhe

- nëngrupi 5 kategoria A punëtor i përgjithshëm, punëtor higjienik, rrobaqepëse, larëse, hekurosës dhe persona tjerë ndihmës-teknikë.

(2) Për çdo kategori në nëngrupet 1, 2, 3, 4 dhe 5 përcaktohen 3 (tre) nivele:

- A01 persona ndihmës - teknik të nivelit të parë, me së paku nivelin IV të kualifikimeve, 240 kredi sipas Sistemit evropian të kredive në arsimin dhe trajnimin profesional (ECVET) ose Sistemit maqedonas të kredive për arsim të përgjithshëm (SMKAP) ose arsim të mesëm katërvjeçar,

- A02 persona ndihmës-teknikë të nivelit të dytë, me së paku nivelin III të kualifikimeve, 180 kredi sipas Sistemit evropian të kredive në arsimin dhe trajnimin profesional (ECVET) ose arsim të mesë trevjeçar dhe

- A03 persona ndihmës-teknikë të nivelit të tretë me së paku nivelin I të kualifikimeve ose arsim fillor.".

Neni 46

Pas nenit 136-a shtohet titulli "1. Punësimi dhe avancimi në institucion publik për fëmijë".

Neni 47

Në nenin 142 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Krahas kushteve të përgjithshme për plotësim të vendit të punës të dhënësve të shërbimeve publike në sferën e mbrojtjes së fëmijëve, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e veçanta në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës, të përcaktuara me nenin 136 të këtij ligji.".

Pas paragrafit (2) i cili bëhet paragraf (3), shtohen nëntë paragrafë të rinj (4), (5) (6), (7), (8), (9), (10), (11) dhe (12), si vijojnë:

"(4) Personat të cilët për herë të parë punësohen në institucion publik për fëmijë si dhënës të shërbimeve publike kanë status të praktikantëve.

(5) Stazhi i praktikantit zgjat një vit.

(6) Praktikanti aftësohet me ndihmën e mentori, i cili mund të jetë nga radhët e dhënësve të shërbimeve të cilit kryejnë punë për të cilën aftësohet praktikanti dhe janë me titull mentor në pajtim me këtë ligj, ndërsa nëse në institucionin nuk ka person me titull mentor praktikanti mund të aftësohet për punë nga ana e udhëheqësi të objekti dhe/ose drejtori i institucionit.

(7) Gjatë kohës së stazhit të praktikantit dhënësit e shërbimeve publike aftësohen për punë të pavarur profesionale nëpërmjet përvetësimit të programit adekuat për provim profesional të cilin e përpilon mentori.

(8) Mentori dhe praktikanti pas përfundimit të mentorimit së bashku përpilojnë deklaratë për mentorim të përfunduar, në të cilën bëjnë vlerësim të realizimit të qëllimeve të përcaktuara në programin nga paragrafi (7) të këtij neni. Deklarata për mentorim të përfunduar në afat prej shtatë ditësh dorëzohet te personi i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose personi i cili i kryen punët për menaxhim me resurse njerëzore nëse nuk ka njësi organizative, i cili në bazë të deklaratës jep vërtetim për mentorim të kryer me sukses.

(9) Në rast se praktikanti nuk i realizon qëllimet, në pajtim me programin nga paragrafi (7) të këtij neni, mentori në afat prej shtatë ditësh dorëzon deklaratë për qëllimet e parealizuara te personi i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose personi i cili i kryen punët për menaxhim me resurse njerëzore nëse nuk ka njësi organizative, i cili në bazë të deklaratës jep vërtetim për mentorim të realizuar pa sukses.

(10) Praktikanti i cili me sukses e realizon mentorimin pas përfundimit të stazhit të praktikantit jep provim profesional para komisionit të përbërë prej tre anëtarëve dhe zëvendësve të tyre prej të cilëve dy nga radhët e dhënësve të shërbimeve publike të cilët janë me së paku shkallë të njëjtë të arsimit me praktikantin dhe një anëtar nga njësia organizative për menaxhim me resurse njerëzore, e nëse nuk ka njësi organizative personi i cili i kryen punët për menaxhim me resurse njerëzore, të formuar nga drejtori i institucionit publik për fëmijë.

(11) Nëse me sukses e jep provimin profesional nga paragrafi (10) të këtij neni, praktikanti sistemohet në nivel të vendit të punës në pajtim me konkursin.

(12) Praktikantit i cili nuk e ka dhënë me sukses provimin profesional i pushon marrëdhënia e punës.".

Neni 48

Neni 143 ndryshohet si vijon:

"(1) Për plotësimin e vendi të zbrazët të punës për ushtrim të punëve me interes publik në institucionet publike për fëmijë, drejtori i institucionit miraton vendim për nevojë nga punësimi i punëtorëve.

(2) Me vendimin nga paragrafi (1) të këtij neni përcaktohet nëse plotësimi i vendi të lirë të punës në institucion bëhet nëpërmjet punësimit të personit me shpallje të konkursi publik, shpallje të konkursi intern dhe mobilitet nëpërmjet sistemimit ose marrjes në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(3) Në institucion publik për fëmijë, nevoja për dhënës të shërbimeve publike sigurohet me shpalljen e konkursi publik në së paku dy gazeta ditore prej të cilave së paku një nga gazetat të cilat botohen në gjuhën maqedonase dhe në gazetat të cilat botohen në gjuhën të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve të cilit flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, në institucionin publik për fëmijë mund të plotësohet vendi i punës nëpërmjet lidhjes së marrëveshje për punësim në kohë të caktuar në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektor publik.

(5) Në raste kur plotësimi i vendi të lirë të punës bëhet nëpërmjet shpalljes të konkursi intern, i njëjti shpallet në tabelën e shpalljeve të institucionit dhe në ueb faqen e institucionit. Procedura për avancim ka për qëllim t'u mundësojë dhënësve të shërbimi publik përparim në karrierë. Gjatë procedurës për avancim respektohet parimi për përfaqësim të drejtë. Procedura për avancim mund të fillojë pasi që të merret njoftim për mjete të siguruara financiare.

(6) Konkursi intern përmban të dhëna për vendin e punës që duhet të plotësohet dhe për kushtet e nevojshme të cilat duhet t'i plotësojë dhënësi i shërbimit publik në pajtim me këtë ligj dhe aktin për organizim dhe sistematizim të brendshëm të vendeve të punës të institucionit dhe afatin për paraqitje në konkursin intern, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se tri ditë pune nga dita e shpalljes së tij. Në konkursin intern mund të paraqitet dhënës i shërbimi i punësuar në institucionin e njëjtë, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara për nivelin adekuat në këtë ligj dhe në aktin e sistematizimit si dhe:

- të jetë i vlerësuar me notë "4" ose "5" gjatë vlerësimit të fundit,

- të ketë kaluar së paku dy vjet në vendin rrjedhës së punës dhe

- të mos i jetë shqiptuar mas disiplinore në vitin e fundit para shpalljes së konkursit intern.

(7) Kandidatët paraqiten në konkursin intern me parashtrimin e fletëparaqitjes së plotësuar dhe dëshmi për të dhënat e përmbajtura në fletëparaqitje dhe të njëjtën nëpërmjet arkivit e dorëzojnë te njësia organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose te personi i cili i kryen punët për menaxhim me resurse njerëzore. Afati për paraqitje nuk mund të jetë më i shkurtër se tre, përkatësisht më i gjatë se dhjetë ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

(8) Drejtori formon komision për seleksionim për avancim, i përbërë prej tre anëtarëve prej të cilëve dy dhënës të shërbimit publik prej të cilëve një me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik për cilin vend pune është shpallur konkursi intern, dhe një i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose personi i cili i kryen punët me menaxhim me resurse njerëzore nëse nuk ka njësi organizative.

(9) Procedura pas konkursit intern përbëhet prej dy faza: seleksionim administrativ i cili përbëhet nga kontrolli i të dhënave të futura në fletëparaqitje dhe dëshmi të dorëzuara në fletëparaqitje dhe intervistë. Për kandidatët për të cilët gjatë seleksionimit administrativ do të përcaktohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkursin intern, procedura për seleksionim përfundon. Për kandidatët e tjerë në afat prej pesë ditësh pune pas përfundimit të seleksionimit administrativ komisioni zbaton intervistë.

(10) Pas seleksionimit të kryer administrativ dhe intervistës, komisioni përpilon rang listë dhe ia propozon kandidatin e parë të ranguar drejtorit. Në afat prej tri ditë pune pas marrjes së propozimit drejtori është i obliguar të miratojë vendim për zgjedhje. Vendimi për përzgjedhje dorëzohet te kandidatët dhe shpallet në internet faqen e institucionit.

(11) Drejtori mund të miratojë vendim për moskryerje të përzgjedhjes, dhe në të njëjtin është i obliguar t'i theksojë shkaqet për miratimin e tij.

(12) Kundër vendimit për zgjedhje ose moskryerjen e zgjedhjes kandidati i pakënaqur mund të deklarojë ankesë te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë

administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit për zgjedhje, përkatësisht nga dita e shpalljes në internet faqen ose tabelën e shpalljeve të vendimit për moskryerjes së zgjedhjes.

(13) Kur drejtori punëson dhënës të shërbimeve publike nëpërmjet konkursit publik, është i obliguar në konkursin publik t'i theksojë kushtet të cilat kërkohen për ushtrim të punës, fillimi dhe përfundimi i kohës ditore dhe javore të punës, sistemimi i kohës së punës dhe shuma në para i rrogës bazë për vendin e punës për të cilin kërkohet dhënës i shërbimi publik dhe afati i paraqitjes, i cili nuk guxon të jetë më i shkurtër se tri ditë pune.

(14) Drejtori formon komision për seleksionim për punësim, i cili është i përpiluar nga kryetari dhe dy anëtarë dhe zëvendës të tyre. Komisioni për seleksionim për punësim përbëhet nga një udhëheqës i objektit, një dhënës i shërbimit publik me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik për të cilin vend pune është shpallur konkursi publik dhe një anëtar të komisionit është personi i punësuar në njësinë organizative për menaxhim me resurse njerëzore ose personi i cili i kryen punët me menaxhim me resurse njerëzore nëse nuk ka njësi organizative, ndërsa nëse nuk ka udhëheqës të objektit, nga radhët e dhënësit të shërbimeve publike.

(15) Procedura pas konkursit publik përbëhet prej dy faza: seleksionim administrativ i cili përbëhet nga kontrolli i të dhënave të futura në fletëparaqitje dhe dëshmi të dorëzuara në fletëparaqitje dhe intervistë. Për kandidatët për të cilët seleksionimi administrativ do të përcaktojë se nuk i plotëson kushtet të përcaktuara në konkursin publik, procedura për seleksionim përfundon. Për kandidatët e tjerë në afat prej pesë ditësh pune pas përfundimit të seleksionimit administrativ komisioni zbaton intervistë.

(16) Pas seleksionimit të kryer administrativ dhe intervistës komisioni përpilon rang–listë dhe në afat prej pesë ditësh ia dorëzon drejtorit dhe ia propozon kandidatin e parë të ranguar drejtorit. Gjatë përpilimit të rang-listës komisioni për seleksionim i zbaton dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik për punësim të kandidatëve me përkatësi të bashkësisë në pajtim me planin vjetor të institucionit.

(17) Drejtori miraton vendim për kryerje ose moskryerje të zgjedhje të kandidatit, në afat prej tetë ditësh pas pranimit të rang-listës nga komisioni për seleksionim, e cila shpallet në tabelën e shpalljeve të institucionit dhe në ueb faqen e institucionit. Vendimi për zgjedhje ose moszgjedhje të kandidatit dorëzohet te kandidatët të cilët e kanë kaluar seleksionimin administrativ.

(18) Kundër vendimit kandidatët e pakënaqur, mund të parashtrojnë ankesë te Komisioni shtetëror për vendosje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

(19) Pas vendimit përfundimtar për zgjedhje të kandidatit, drejtori lidh marrëveshje për punësim me kandidatin e përzgjedhur.

(20) Parimet e organizimit të brendshëm të institucioneve publike për fëmijë - çerdhe për fëmijë i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

(21) Institucioni publik për fëmijë, pas marrjes së pëlqimit të akteve nga alineja 8 të neneve 116 dhe 117 të këtij ligji nka këshilli i komunës dhe të komunës së Qytetit të Shkupit, detyrimisht duhet të sigurojë mendim nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.”.

Neni 49

Neni 147 shlyhet.

Neni 50

Neni 148 ndryshohet si vijon:

"(1) Të punësuarit në institucion publik për fëmijë si dhënës të shërbimeve publike, personalisht janë përgjegjës për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës në vendin e punës.

(2) Për shkelje të detyrës zyrtare, i punësuari nga paragrafi (1) të këtij neni përgjigjet në mënyrë disiplinore, për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore.

(3) Parregullsia disiplinore paraqet cenim më të lehtë të disiplinës së punës, detyrave të punës, prestigjit të institucionit ose të dhënësit të shërbimit publik, edhe atë:

- mosrespektim të kohës së punës, orarit dhe shfrytëzimit të kohës së punës,

- ruajtje të parregullt të shkresave dhe të dhënave zyrtare,

- mosardhje në punë dy ditë pune gjatë një viti kalendarik pa arsyetim,

- moskryerje të punëve, kryerje të punëve në mënyrë të pandërgjegjshme, jo në kohë ose në mënyrë të pakujdesshme dhe detyrave të punës, me pasoja më të lehta nga cenimi,

- sjellja e pahijshme e dhënësit të shërbimit publik gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës me pasoja më të lehta nga cenimi,

- shfrytëzimi joekonomik dhe përdorimi i mjeteve të besuara financiare dhe mjeteve për punë,

- njoftim i paarsyeshëm i udhëheqësit të objektit, përkatësisht i drejtorit për pengim për mosardhje në punë në afat prej tri orësh dhe

- refuzim i aftësimit profesional dhe përsosjes në të cilin dhënësi i shërbimit publik dërgohet.

(4) Shkelje disiplinore paraqet cenim më i rëndë i detyrës zyrtare, disiplinës së punës, prestigjit të institucionit ose prestigjit të dhënësit të shërbimit publik, edhe atë:

- moskryerje w punëve, kryerje e detyrave të punës në mënyrë të pandërgjegjshme, jo në kohë ose në mënyrë të pakujdesshme me pasoja më të rënda nga cenimi,

- sjellja e pahijshme e dhënësit të shërbimit publik gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të punës me pasoja më të rënda nga cenimi,

- shprehja dhe përfaqësimi i bindjes politike në ushtrimin e detyrave të punës, pjesëmarrje në aktivitete zgjedhore ose pjesëmarrje tjera publike të karakterit të tillë

gjatë kohës së punës, sjellje në pyetje të statusit të vet të dhënësit të shërbimit publik me kryerje të aktiviteteve partiake, mbajtje ose theksim të simbolit partiak në hapësirën e punës.

- refuzim të dhënies ose dhënie të të dhënave të pasakta institucioneve, përkatësisht qytetarëve dhe personave juridikë, nëse dhënia e të dhënave është përcaktuar me ligj,

- disponimi i paligjshëm me mjete materiale dhe financiare,

- refuzimi i ushtrimit të detyrave të punës të lidhura me vendin e punës në të cilin është sistemuar,

- refuzim i urdhrit me shkrim për kryerje të detyrave të punës të lidhura me punën e institucionit të dhëna nga udhëheqësi i objektit përkatësisht drejtori,

- mosndërmarrje ose ndërmarrje e paplotë e masave të përcaktuara për sigurim të sigurisë së lëndëve të besuara në punë,

- shkaktim të dëmit material me qëllim ose nga pakujdesia e skajshme,

- përsëritje të parregullsisë disiplinore më shumë se dy herë gjatë vitit,

- pranim të dhuratave ose lloj tjetër të dobisë,

- keqpërdorim të pushimit mjekësor,

- keqpërdorim të të dhënave të besueshme,

- keqpërdorim të të dhënave personale,

- keqpërdorim të autorizimeve të besuara me ushtrimin e detyrave të punës,

- futje dhe përdorim, si dhe punë nën ndikim të alkoolit ose mjeteve narkotike,

- mospërmbajtje në rregullat për mbrojtje nga sëmundja, siguria dhe shëndeti gjatë punës, zjarri, eksplozioni, ndikim të dëmshëm të helmeve dhe materie tjera të rrezikshme dhe të rregullave për mbrojtje të mjedisit jetësor,

- vendosje të interesit personal financiar në konflikt me pozitën dhe statusin e dhënësit të shërbimit publik,

- sjellje ofenduese ose të dhunshme,

- zbulim të informatës së klasifikuar me shkallë të sekretit të përcaktuar me ligj,

- mosveprim pas detyrimit për vlerësim të dhënësit të shërbimit publik,

(5) Përgjegjësia për vepër të kryer penale, përkatësisht shkelje nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të të punësuarit.

(6) Me vendim për parregullsi të përcaktuar disiplinore të dhënësit të shërbimit publik mund t'i shqiptohet një nga këto masa disiplinore:

- vërejtje me shkrim dhe

- dënim me para në lartësi prej 10% të lartësisë së shumës një mujore të neto rrogës të paguar në muajin e fundit para parregullsisë të kryer disiplinore në kohëzgjatje prej një deri në tre muaj.

(7) Me vendim për parregullsi të përcaktuar disiplinore të dhënësit të shërbimi publik mund t'i shqiptohet një nga këto masa disiplinore si në vijim:

- dënim me para në lartësi prej 30% të lartësisë së shumës një mujore të neto rrogës të paguar në muajin e fundit para parregullsisë së kryer disiplinore në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj dhe

- pushimi i marrëdhënies së punës kur janë krijuar pasoja të dëmshme për institucionin, ndërsa me ç'rast nuk janë përcaktuar rrethana lehtësuese për dhënësin e shërbimi publik cili e ka bërë shkeljen.

(8) Në vendimet nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni në mënyrë të obligueshme theksohet data nga e cila të njëjtat kryhen.

(9) Shuma e dënimeve në para të shqiptuara dhënësit të shërbimit publik në një muaj për parregullsi disiplinore dhe shkelje disiplinore nuk mund të tejkalojë 30% të shumës së neto rogës së tij të përgjithshme për atë muaj.”.

Neni 51

Neni 156 ndryshohet si vijon:

"(1) Çdo dhënës i shërbimit publik dhe person tjetër, në pajtim me ligj ka të drejtë të parashtrojë iniciative për ngritje të procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimit publik në institucion publik për fëmijë, e cila duhet të jetë e arsyetuar.

(2) Propozimi për ngritje të procedurës disiplinore kundër dhënësit të shërbimit publik parashtron udhëheqësi i objektit ose drejtori i institucionit publik për fëmijë.

(3) Propozimi për ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë disiplinore sipas rregullës i përmban këto elemente:

- emrin personal të dhënësit të shërbimit publik për të cilin parashtrohet propozimi për ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë disiplinore,

- vendin e punës në të cilin është sistemuar dhënësi i shërbimi publik për të cilin parashtrohet propozimi,

- përshkrimin e veprimit/ve me të cilat është bërë shkelje e rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësimi i detyrave të punës,

- theksimin e kualifikimit të veprimit/ve nga paragrafi (3) alineja 3 të këtij neni me theksim konkret nëse ajo paraqet shkelje më të lehtë, përkatësisht më të rëndë të rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësim të detyrave të punës,

- kohën, mënyrën dhe vendin e ushtrimit të veprimit me të cilin është bërë shkelja e rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësim i detyrave të punës,

- pasojat të cilat janë krijuar nga shkelja e kryer e rendit të punës dhe disiplinës ose mosplotësim ië detyrave të punës,

- theksimin e dëshmisë/ve nga të cilat përcaktohet sjellja e tillë, përkatësisht dëshmi që është në shtojcë të faktit se është kryer veprim (shënim zyrtar, raport me shkrim, informatë, fletëparaqitje, deklarata nga dëshmirtarët),

- theksimin e emrit personal të personit i cili mund të jetë i ftuar në cilësinë e dëshmitarit, - të dhënën nëse dhënësi i shërbimit publik për të cilin parashtrohet

propozimi deri atëherë është përgjigjur për shkelje të rendit dhe disiplinës së punës ose mosplotësim të detyrave të punës në institucionin publik për fëmijë dhe

- të dhënën në lidhje me shpërblime përkatëse të dhënësit të shërbimit publik.

(4) Në shtojcë të propozimit nga paragrafi (3) i këtij neni dorëzohen dëshmitë të cilat janë theksuar në të njëjtin dhe dokumente të tjera që sipas vlerësimit të propozuesit janë me rëndësi për rastin konkret.".

Neni 52

Pas nenit 156 shtohen tre nene të reja 156-a, 156-b dhe 156-v, si vijojnë:

"Neni 156-a

(1) Drejtori i institucionit publik për fëmijë formon komision për mbajtje të procedurës disiplinore për shkeljes disiplinore në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për ngritje të procedurës disiplinore.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni është i përbërë prej tre anëtarëve edhe atë një udhëheqës i objektit dhe dy dhënës të shërbimit publik prej të cilëve një me titull të njëjtë ose më të lartë me dhënësin e shërbimit publik kundër të cilit mbahet procedura disiplinore, ndërsa nëse nuk ka udhëheqës të objektit nga radhët e dhënësve të shërbimeve.

(3) Kryetari i komisionit është nga radhët e udhëheqësve të objektit/ve, ndërsa nëse nuk ka udhëheqës të objektit nga dhënësit e shërbimit publik. Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë zëvendës.

(4) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, pas procedurës së zbatuar disiplinore, i propozon masë adekuate disiplinore drejtorit të institucionit publik për fëmijë.

(5) Nëse komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni përcakton se dhënës i shërbimit publik nuk është përgjegjës ose nuk janë plotësuar kushtet për miratim të aktvendimit për shqiptim të masës disiplinore i propozon drejtorit ta refuzojë propozimin, përkatësisht ta ndërpresë procedurën.

(6) Drejtori i institucionit publik për fëmijë në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës, në bazë të propozimit të komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni miraton aktvendim për shqiptim të masës disiplinore për shkelje disiplinore.

Neni 156-b

(1) Masat disiplinore për parregullsi disiplinore të dhënësit të shërbimi publik në institucionin publik për fëmijë i shqipton drejtori i institucionit publik, ndërsa pas raportit paraprak me shkrim nga udhëheqësi i objektit.

(2) Para shqiptimit të masës disiplinore dhënësi i shërbimit publik njoftohet me shkrim për konstatimet të raportit nga paragrafi (1) i këtij neni që ekzistojnë kundër tij dhe i njëjti ka të drejtë të japë përgjigje me gojë ose me shkrim në afat i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se tetë ditë nga dita e pranimit të raportit.

(3) Nëse dhënësi i shërbimi publik nuk dëshiron ta pranojë njoftimin për konstatimet në raportin nga paragrafi (2) i këtij neni në afat prej tri ditësh, i njëjti do të shpallet në tabelën e shpalljeve në selinë e institucionit publik për fëmijë.

(4) Drejtori i institucionit publik për fëmijë në afat prej 60 ditësh nga dita e fillimit të procedurës miraton aktvendim për shqiptim të masës disiplinore.

(5) Kundër aktvendimit për shqiptim të masës disiplinore nga neni 148 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji, dhënësi i shërbimit publik në institucionin publik për fëmijë ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të aktvendimit te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

Neni 156-v

(1) Dhënësi i shërbimi publik në institucionin publik për fëmijë është përgjegjës për dëmin të cilin në punë ose në lidhje me punën me qëllim ose me pakujdesi të skajshme ia ka shkaktuar institucionit publik për fëmijë.

(2) Drejtori i institucionit publik për fëmijë formon komision për përcaktim të përgjegjësisë materiale të dhënësit të shërbimit publik.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni është përbërë prej kryetarit, cili është udhëheqës i objekti ose dhënës i shërbimit publik i cili nuk është me titull më të ulët nga titulli i dhënësi të shërbimit publik kundër të cilit mbahet procedurë për përgjegjësi materiale dhe dy anëtarë prej të cilëve njëri është dhënës i shërbimi publik, ndërsa tjetri është përfaqësues i sindikatës. Kryetari dhe anëtarët e komisionit kanë zëvendës.

(4) Komisioni nga paragrafi (2)i këtij neni e përcakton përgjegjësinë materiale për ekzistim të dëmit të bërë material, lartësinë e tij dhe mënyrën e krijimit, kush e ka shkaktuar dëmin dhe kush do ta kompensojë.

(5) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni për gjendjen e përcaktuar faktike parashtron raport në bazë të të cilit drejtori i institucionit publik për fëmijë miraton aktvendim për kompensim të dëmit.

(6) Propozimi për ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë materiale kundër dhënësit të shërbimit publik në institucionin publik për fëmijë parashtron udhëheqësi i objektit ose drejtori i institucionit.

(7) Procedura për përcaktim të përgjegjësisë materiale nuk mund të ngrihet nëse kanë kaluar 30 ditë nga dita kur udhëheqësi i objektit, përkatësisht drejtori ka ardhur në dijeni për atë, përveç kur procedura ngrihet pas konstatimit të revizionit të brendshëm për çka afati për skadim është një vit.

(8) Procedura për përcaktim të përgjegjësisë materiale nuk mund të mbahet më gjatë se 60 ditë, duke konsideruar nga dita e miratimit të aktvendimit për formim të komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(9) Kundër dhënësit të shërbimit publik i cili në afat prej 60 ditësh nga përfundimi i vendimit për kompensim të dëmit, nuk e kompenson dëmin, institucioni ngre procedurë para gjykatës themelore kompetente.

(10) Drejtori, mundet plotësisht ose pjesërisht ta lirojë dhënësin e shërbimit publik nga kompensimi i dëmit, nëse ajo nuk është bërë me qëllim ose nëse me plotësimin e kompensimit për dëmin e krijuar kërcënohet ekzistenca e dhënësit të shërbimit publik dhe familjes së tij ose në raste të tjera të përcaktuara me marrëveshje kolektive.

(11) Kundër aktvendimit nga neni i paragrafit (5) të këtij neni dhënësi i shërbimit publik në institucionin publik për fëmijë ka të drejtë të deklarojë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.".

Neni 53

Pas nenit 156-v shtohet titulli "5. Ndërprerja e marrëdhënies së punës" dhe tre nene të reja 156-g, 156-d dhe 156-gj, si vijojnë:

"5. Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Neni 156-g

(1) Dhënësit të shërbimit publik i pushon marrëdhënia e punës:

- me kërkesë të tij,
- me marrëveshje,
- me fuqinë e ligjit dhe
- në raste të tjera të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër dhe marrëveshje kolektive.

(2) Dhënësit të shërbimit publikë i pushon marrëdhënia e punës në institucion nëse parashtron kërkesë me shkrim për pushimin e marrëdhënies së punës.

(3) Në rast të pushimit të marrëdhënies së punës sipas kërkesës së dhënësit të shërbimit publik, afati i dorëheqjes zgjat 30 ditë nga dita e parashtrimit të kërkesës për pushim të marrëdhënies së punës.

Neni 156-d

(1) Dhënësit të shërbimit publik i pushon marrëdhënia e punës sipas fuqisë së ligjit nëse:

- e humb aftësinë e punës në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për përcaktimin e aftësisë së humbur të punës,
- i pushon shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ditën e dorëzimit të aktvendimit për heqje të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- të jetë i dënuar për vepër penale në lidhje me detyrën zyrtare në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,
- i është shqiptuar ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në ditën e plotfuqishmërisë së aktgjykimit,
- për shkak të vuajtjes së dënimit me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, në ditën e fillimit të vuajtjes së dënimit,
- mungesë e paarsyeshme nga puna së paku tri ditë pune njëra pas tjetrës në një muaj,
- u konstatua se gjatë punësimit ka heshtur ose ka dhënë të dhëna të pavërteta në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe kushtet e posaçme për punësim,
- në afat prej tri ditësh nuk është kthyer në punë pas përfundimit të mungesës pa pagesë,
- organi i administratës shtetërore kompetent për mbikëqyrjen inspektuese, në afat prej një viti përcakton se dhënësi i shërbimit publik është i punësuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe kushte të tjera në pajtim me këtë ligj dhe ligje të tjera.

(2) Dhënësit të shërbimit publik i pushon marrëdhënia e punës nëse është vlerësuar me notë "nuk kënaq" dy herë njëra pas tjetrës ose së paku tri herë në pesë vjetët e fundit.

Neni 156-gj

(1) Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhënësit të shërbimit publik e miraton drejtori.

(2) Aktvendimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dorëzohet personalisht dhënësit të shërbimit publik në ambientet e punës të institucionit në të cilin punon, përkatësisht në adresën e vendbanimit të tij.

(3) Nëse dhënësi i shërbimit publik nuk mund të gjendet në adresën e vendbanimit ose nëse e refuzon dorëzimin, aktvendimi publikohet në tabelën e shpalljes së institucionit dhe pas kalimit të tetë ditëve llogaritet se aktvendimi është dorëzuar.

(4) Kundër aktvendimit dhënësi i shërbimit publik nga dita e pranimit të aktvendimit ka të drejtë në afat prej tetë ditësh të paraqesë ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.".

Neni 54

Pas nenit 166 shtohet titull i ri "6. Rroga të dhënësve të shërbimeve në institucionet publike për fëmijë dhe të drejtorëve të institucioneve publike për fëmijë", nëntitull "6.1. Rrogë komponenti" dhe dy nene të reja 166-a dhe 166-b, si vijojnë:

„6. Rroga të dhënësve të shërbimeve në institucionet publike për fëmijë dhe të drejtorëve të institucioneve publike për fëmijë

6.1. Rrogë komponenti

Neni 166-a

Rroga e dhënësit të shërbimit publik përbëhet nga këto komponentë

- komponenti themelor dhe
- komponenti i jashtëzakonshëm.

Neni 166-b

(1) Komponentin themelor të rrogës e përbëjnë:

- pjesa e rrogës për shkallën e arsimimit,
- pjesa e rrogës për nivel dhe

- pjesa e rrogës për stazh

(2) Pjesa e rrogës për shkallën e arsimimit e cila është ligjërisht minimum për nivelin përkatës të vendit të punës vlerësohet në këtë mënyrë:

| NIVELI I KUALIFIKIMEVE/ARSIMIMI | PIKË |
|---|---|
| Niveli i kualifikimeve VIA, 240 kredi sipas SETK-së ose të përfunduar shkallën VII/1 | 200 |
| Niveli i kualifikimeve VI B ose 180 kredi sipas SETK-së | 175 |
| Niveli i kualifikimeve VA, 60 për 120 sipas SETK-së ose arsim të lartë | 150 |
| Niveli i kualifikimeve IV, 240 sipas ECVET ose MKSOO ose arsimin e mesëm katërvjeçar | 100 |

(3) Pjesa e rrogës për nivelin në të cilin është rradhitur dhënësi i shërbimit publik vlerësohet në këtë mënyrë:

| NIVELI | PIKË |
|---|---|
| A1 udhëheqës i objektit | 310 |
| B1 punëtor profesional-këshilltarë | 290 |
| B2 punëtor profesionist-mentor | 275 |
| B3 punëtor profesionist | 265 |
| B4 punëtor profesionist – praktikant | 212 |
| V1 edukatorë-këshilltarë | 285 |
| B2 edukator - mentor | 265 |
| V3 edukator | 255 |
| V4 edukator-praktikant | 204 |
| G1 bashkëpunëtor profesionist-këshilltar | 225 |
| G2 bashkëpunëtor profesionist-mentor | 220 |
| G3 bashkëpunëtor profesionist | 215 |
| G4 bashkëpunëtor profesionist - praktikant | 172 |
| D1 përkëdhelës/punëtor profesionist ndihmës-këshilltarë | 265 |
| D2 përkëdhelës/punëtor profesionist ndihmës-mentor | 260 |
| D3 përkëdhelës/punëtor profesionist ndihmës | 240 |
| D4 përkëdhelës/punëtor profesionist-ndihmës-praktikant | 192 |

(4) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të dhënësit të shërbimit publik vlerësohet në shumë prej 0.5 % nga pjesët e rrogës për nivelin e arsimit dhe për nivel, për çdo vit të përfunduar stazh pune, kurse më së shumti deri në 20%.".

Neni 55

Pas nenit 166-b shtohet nëntitull i ri "6.2. Komponenti i jashtëzakonshëm" dhe nen i ri 166-v, si vijojnë:

„6.2. Komponenti i jashtëzakonshëm

Neni 166-v

Komponentin e jashtëzakonshëm e përbëjnë shtesa e rrogës për punë nate, puna në ndërrime dhe puna jashtë orarit.“.

Neni 56

Pas nenit 166-v shtohet nëntitull i ri “6.3. Shtesë e rrogës për punë nate, punë në ndërrime dhe punë jashtë orarit " dhe nen i ri 166-g, si vijojnë:

„6.3. Shtesë e rrogës për punë nate, punë në ndërrime dhe punë jashtë orarit

Neni 166-g

(1) Dhënësi i shërbimit publik ka të drejtë të shtesës së rrogës për:

- punë nate,
- punë në ndërrime,
- punë gjatë kohës së pushimit javor,
- punë gjatë festave të përcaktuara me ligj dhe
- punë më të gjatë nga orari i plotë i punës

(2) Shtesat e rrogës nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë të parapara në aktin për sistematizim të vendeve të punës në institucione.

(3) Shtesa rrogës për punë nate për orë vlerësohet në shumë prej 35% nga shuma e rrogës themelore për orë.

(4) Shtesa e rrogës për punë në ndërrime për orë vlerësohet në shumë prej 5% nga shuma e rrogës themelore të llogaritur për orë.

(5) Dhënësi i shërbimit publik i cili ka qenë i angazhuar të punojë në pajtim me kushtet e paragrafit (1), alinetë 3, 4 dhe 5 të këtij neni, ka të drejtën të aq orëve të lira përkatësisht ditëve sa ka qenë i angazhuar për punë jashtë orarit të rregullt të punës.

(6) Orët e lira, përkatësisht ditët nga muaji rrjedhës dhënësi i shërbimit publik i shfrytëzon deri në fund të muajt të ardhshëm, për muajin në të cilin ka qenë i angazhuar.

(7) Nëse dhënësit të shërbimit publik nuk i janë siguruar shfrytëzim i orëve të lira përkatësisht ditëve në pajtim me paragrafin (6) të këtij neni, i paguhet shtesë e rrogës në shumën prej 35% nga shuma e rrogës themelore, të llogaritur në orë.

(8) Shtesat e rrogës nga paragrafi (1)i këtij neni nuk përjashtohen.”.

Neni 57

Pas nenit 166-g shtohet nëntitull i ri “6.4. Kompensime të tjera të rrogës “ dhe nen i ri 166-d, si vijojnë:

„6.4. Kompensime të tjera të rrogës

Neni 166-d

(1) Dhënësi i shërbimit publik ka të drejtë të kompensimeve të rrogës dhe kompensime të tjera në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune, dhe atë për:

- shpenzime rrugore, ditore dhe shpenzime tjera për udhëtime zyrtare jashtë vendit,
- shpenzime për udhëtime zyrtare në vend,
- shpenzime për shfrytëzimin e automjeteve në pronësi personale për qëllime zyrtare,

- shpenzime për jetë të ndarë nga familja,
- shpenzime të shpërnguljes,
- shpenzime për punë në terren,
- shpenzime për varrim në rast të vdekjes së dhënësit të shërbimit publik ose anëtarit të familjes së tij të afërt (bashkëshort dhe fëmijët e lindur në martesë ose jashtë martese, fëmijët e adoptuar, fëmijët e birësuar dhe fëmijët e marrë nën kujdes),
- dëme gjatë fatkeqësive elementare dhe
- shpenzime gjatë pushimit mjekësor më të gjatë të dhënësit të shërbimit publik.

(2) Lartësia e kompensimeve nga paragrafi (1) alinetë 7 dhe 8 të këtij neni përcaktohen me Ligjin për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Lartësia e kompensimeve nga paragrafi (1) alinetë 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 të këtij neni përcaktohet në Marrëveshjen kolektive për institucionet publike për fëmijë në veprimtarinë kujdes dhe edukim i fëmijëve dhe në veprimtarinë pushim dhe rekreacion i fëmijëve.".

Neni 58

Pas nenit 166-d, shtohet nëntitull i ri "6.5. Kompensimi gjatë paaftësisë së përkohshme për punë" dhe nen i ri 166-gj, si vijojnë:

„6.5. Kompensimi gjatë paaftësisë së përkohshme për punë

Neni 166-gj

(1) Nëse te dhënësi i shërbimit publik ndodh pa aftësi e përkohshme për punë ka të drejtë të kompensimit për rrogë në lartësi të përcaktuar me ligj.

(2) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet me Marrëveshje kolektive për institucionet publike për fëmijë në veprimtarinë kujdes dhe edukim i fëmijëve dhe në veprimtarinë pushim dhe rekreacion i fëmijëve ."

Neni 59

Pas nenit 166-gj shtohet nëntitull i ri "6.6. Roga gjatë pushimit vjetor ose trajnimi i specializuar" dhe nen i ri 166-e, si vijojnë:

"6. 6. Roga gjatë pushimit vjetor ose trajnimi i specializuar

Neni 166-e

Gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor ose trajnimit të specializuar për përsosje profesionale për nevojat e institucionit, dhënësi i shërbimit publik ka të drejtë rroge në lartësinë e rrogës që do ta marrte në muajin rrjedhës kur do të ishte në punë.".

Neni 60

Pas nenit 166-e shtohet nëntitull i ri "6.7. Roga dhe kompensime të rrogës për drejtor të institucionit publik për fëmijë si organ i menaxhimit" dhe nen i ri 166-zh, si vijojnë:

"6.7. Roga dhe kompensimet e rrogës për drejtor të institucionit publik për fëmijë si organ i menaxhimit

Neni 166-zh

(1) Drejtori i institucionit publik për fëmijët si organ i menaxhimit ka të drejtë të rrogës dhe kompensimeve të rrogës, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me këtë ligj dhe / ose marrëveshje kolektive.

(2) Roga e drejtorit në institucionin për fëmijë llogaritet në shumë bruto, kurse paguhet në shumë neto në para një herë në muaj në muajin rrjedhës për muajin paraprak. Roga përbëhet nga:
- pjesë të rrogës për shkallën e arsimimit,
- pjesë e rrogës sipas kapacitetit të projektuar dhe
- pjesë e rrogës për stazhin e punës.

(3) Me rrogën bazë e cila i paguhet drejtorit të institucionit për fëmijët sigurohet vlerësimi i nivelit të arsimit në pajtim me nenin 120 paragrafin (2), përkatësisht në pajtim me nenin 120 paragrafin (3) të këtij ligji, e cila vlerësohet në 200 pikë.

(4) Pjesën e rrogës së drejtorit sipas kapacitetit të projektuar të institucionit publik për fëmijë (kopsht fëmijësh/qendra për zhvillim të hershëm fëmijëror/pushimore fëmijësh) vlerësohet me pikë, dhe atë:
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar deri në 100 fëmijë.................360 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 101 deri në 200 fëmijë.... 375 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 201 deri në 300 fëmijë..... 390 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 301 deri në 400 fëmijë.... 405 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 401 deri në 500 fëmijë.... 420 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 501 deri në 600 fëmijë.... 435 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 601 deri në 700 fëmijë.... 450 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 701 deri në 800 fëmijë.... 465 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 801 deri në 900 fëmijë......480 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar nga 901 deri në 1000 fëmijë....495 pikë,
- për institucion për fëmijë me kapacitet të projektuar mbi 1000 fëmijë.... 510 pikë.

(5) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të drejtorit të institucionit publik për fëmijë vlerësohet në shumë prej 0,5% nga pjesët e rrogës për shkallën e arsimit dhe sipas kapacitetit të projektuar për çdo vit të përfunduar të stazhit të punës, kurse më së shumti deri në 20 %.

Neni 61

Pas nenit 166-zh shtohet nëntitull i ri "6.8. Vlera e pikës " dhe neni i ri 166-z, si vijojnë:

„6.8. Vlera e pikës

Neni 166-z

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut çdo vit me vendim e përcakton shumën maksimale të vlerës së pikës për llogaritjen e rrogave të dhënësve të shërbimeve publike me propozim të ministrit të Punës dhe Politikës Sociale, kurse komunat e përcaktojnë vlerën e pikës që nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse në korniza të buxhetit të paraparë dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të dhënësve të shërbimeve publike të radhitura sipas niveleve përkatëse për vitin rrjedhës.”.

Neni 62

Në nenin 167 në paragrafin (1) alineja 4 ndryshon si vijon:

"- bashkëpunëtor profesionist (pedagog i muzikës, pedagog i artit, pedagog për edukim fizik, fakultet të përfunduar për artin muzikor, fakultet i arsimit fizik, sport dhe shëndet, fakultet i arteve figurative, profesor i gjuhës dhe letërsisë së huaj),

Pika 2) ndryshon si vijon:

"2) Edukatorë mund të jenë profesor të diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar i fëmijëve të moshës parashkollore, pedagog i diplomuar për edukimin parashkollor dhe pedagog i diplomuar - me 240 kredi SETK të arritura ose arsim të lartë të përfunduar shkallën VII / 1 dhe licencë të vlefshme për edukator; "

Pika 3) shlyhet.

Pika 4) bëhet pikë 3).

Pika 5), e cila bëhet pikë 4), ndryshon si vijon:

“4) Përkëdhelës mund të jenë persona me shkollën e mesme katërvjeçare të përfunduar: shkolla e mesme e mjekësisë - drejtimi i përgjithshëm, arsimi i mesëm – drejtimi gjimnaz, shkolla e mesme e muzikës, shkolla e mesme e arteve, shkolla e mesme e edukatës fizike dhe me leje të vlefshme për përkëdhelës.”

Në pikën 6), e cila bëhet pika 5), pas fjalëve: "infermiere / teknik mjekësor - me 180 kredi të arritura sipas SETK ose të përfunduar shkallën VI / 1 dhe licencë të vlefshme për bashkëpunëtor profesionist", vendoset pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Pika 7) shlyhet.

Pika 8) bëhet pikë 6).

Neni 63

Në nenin 169 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

“(2) Në këshillimore nga paragrafi (1) të këtij neni formohet ekip multidisiplinar/gjithëpërfshirës".

Paragrafi (2) bëhet paragraf (3).

Neni 64

Neni 175 ndryshon si vijon:

"Ministria formon komision për lëshimin, ripërtëritjen, vazhdimin dhe revokimin e licencave për punë personave që janë të interesuar që të përfshihen në sistemin e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore, drejtorëve të institucioneve për fëmijë dhe të personave të përfshirë në sistemin e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore.“.

Neni 65

Neni 176 ndryshon si vijon:

“ Komisioni nga neni 175 i këtij ligji është i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, dhe atë nga: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - katër anëtarë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - një anëtar, Ministria e Financave - një anëtar, Byroja për Zhvillimin e Arsimit - dy anëtarë dhe nga fakultete dhe institute për shkenca shoqërore humane - tre anëtarë.”.

Neni 66

Neni 177 ndryshon si vijon:

"(1) Komisioni nga neni 175 i këtij ligji kryen licencimin e personave të cilët janë të interesuar të përfshihen në sistemin e kujdesit dhe arsimit për fëmijë të moshës parashkollore, të personave të interesuar për drejtorë të institucioneve të fëmijëve, personave të interesuar për udhëheqës në kopshtet e fëmijëve/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve, si njësi organizative e themeluar nga ana dhe në përbërje të personave juridikë, institucionet e arsimit të lartë dhe të shkollave private dhe të personave të përfshirë në sistemin për kujdes dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore (drejtorë të institucioneve për fëmijët, person i cili drejton me kopshte të fëmijëve/qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, si njësi organizative e themeluar nga ana dhe në përbërje të personave juridikë, institucionet e arsimit të lartë dhe shkolla private; punëtorë profesionistë, bashkëpunëtorë profesionistë, edukatorë dhe përkëdhelës në institucionet për kujdes dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore; persona fizikë që kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria kujdes dhe edukim i fëmijëve të moshës parashkollore; persona të punësuar në agjenci për dhënien e shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore ).

(2) Ministri në propozim të Komisionit për licencim lëshon, ripërtërin, vazhdon dhe merr licenca për punë të personave nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Kundër vendimit të ministrit për licenca të lëshuara, vazhduara, të ripërtërira dhe të hequra për punë, mund të deklarohet ankesë te Komisioni Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë nga Marrëdhënia e Punës në Shkallë të Dytë.

(4) Licenca për punë është dokument publik dhe lëshohet në një ekzemplar.

(5) Në rast se licenca për punë humbet ose asgjësohet ministri sipas propozimit të dorëzuar nga Komisioni për Licencim lëshon ekzemplar të ri - duplikat. Shpenzimet për lëshimin e ekzemplarit të ri - duplikat të licencës për punë i bart kërkuesi dhe janë në lartësi të shumës së shpenzimeve për lëshimin e licencave për punë të nenit 182 paragrafi (3) të këtij ligji.”.

Neni 67

Pas nenit 177 shtohet nëntitull i ri si vijon: “1. Pajisje me licencë për punë”.

Neni 68

Në nenin 177-a paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Personat e interesuar për drejtorë të institucioneve për fëmijët, personat që do të menaxhojnë me njësitë organizative në përbërje të personit juridik të nenit 16 paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij ligji; punëtorë profesionistë, bashkëpunëtorë profesionistë, edukatorë dhe përkëdhelës në institucione për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore; persona fizikë të cilët do të kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria kujdes dhe edukim i fëmijëve të moshës parashkollore dhe për persona që do të jenë të angazhuar / të punësuar në agjencitë për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe kujdes të fëmijëve të moshës parashkollore japin provim profesional për marrjen e licencës për punë për shkak të kontrollit të njohurisë profesionale të nevojshme për punë.".

Në paragrafin (2) në fjalinë hyrëse pas fjalëve: “Provim profesional” shtohen fjalët “për marrjen e licencës për punë”.

Alineja 1 ndryshon si vijon:

- të ketë diplomë ose vërtetim për arsim të përfunduar në pajtim me nenin 120 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji për drejtorët e institucioneve për fëmijë, të kenë diplomë ose vërtetim për arsim të përfunduar për person udhëheqës në pajtim me nenin 120-a të këtij ligji, neni 136, paragrafi (6), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij ligji për dhënës të shërbimeve publike për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve për institucionet publike për fëmijë, neni 167, paragrafi (1) alinetë 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji për persona profesionistë për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve për institucione private për fëmijë, neni 77 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji për person të angazhuar nga agjencia për dhënie të shërbimeve për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore dhe nenin 87 paragrafin (1) alinenë 1 të këtij ligji për person fizik i cili në mënyrë të pavarur kryen punë të caktuara nga veprimtaria kujdes dhe edukim të fëmijëve si veprimtari profesionale.”.

Në alinenë 2 fjala "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Alineja 4 shlyhet.

Neni 69

Në nenin 177-b në paragrafin (1) në fjalinë hyrëse pas fjalëve: “Provim profesional” shtohen fjalët: “për pajisje të licencës për punë”.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: “shembull praktik” shtohen fjalët: “(studim i rastit)”.

Neni 70

Neni 177 – v ndryshon si vijon:

“(1) Provimi profesional për pajisje të licencës për punë jepet sipas programit në të cilin janë përfshirë përmbajtja, dispozitat dhe literatura.

(2) Programin për dhënien e provimit nga sfera përkatëse e miraton Komisioni nga neni 175 i këtij ligji.”.

Neni 71

Në nenin 177-g në paragrafin (2) fjalët: “përfaqësues i BNJVL-së”, zëvendësohen me fjalët: “përfaqësues nga Byroja për Zhvillim të Arsimit”.

Në paragrafin (9) fjalët "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Neni 72

Në nenin 177-d në paragrafin (2) pas fjalës “provim” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Në paragrafin (3) fjalët: “dhe servisi radiodifuziv publik” shlyhen.

Në paragrafin (5) pas fjalës "provimi" shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Neni 73

Në nenin 177-gj në paragrafin (1) pas fjalëve: “Provimin profesional” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafi (4) bëhet paragraf (3).

Në paragrafin (5) i cili bëhet paragraf (4), numri “(4)” zëvendësohet me numrin “(3)”.

Paragrafët (6), (7), (8) dhe (9) bëhen paragraf (5), (6), (7) dhe (8).

Neni 74

Në nenin 177-e në paragrafët (1) dhe (2) pas fjalës “provimi” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: “pjesa e dytë e provimit” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Në paragrafin (4) pas fjalëve: “provimi” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”, kurse numri "(4)” zëvendësohet me numrin “(3)”.

Në paragrafin (9) numri “(4)” zëvendësohet me numrin “(3)”.

Neni 75

Në nenin 177-zh pas fjalëve: “dhënia e provimit” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Neni 76

Në nenin 177-z në paragrafin (1) pas fjalës “Provimi” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Neni 77

Në nenin 177-x në paragrafin (6) numri “30” zëvendësohet me numrin “10”.

Neni 78

Në nenin 177-j në paragrafin (1) pas fjalëve: “provimin profesional” shtohen fjalët: “për marrjen e licencës për punë”.

Neni 79

Pas nenit 178 shtohet nëntitull i ri, si vijon: “ 2. Ripërtëritja dhe vazhdimi i licencës për punë”.

Neni 80

Neni 179 ndryshon si vijon:

"(1) Ripërtëritja e lejes për punë ka të bëjë me personat që kanë fituar licencë për punë nga neni 178 paragrafi (1) të këtij ligji dhe të cilët gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës kanë ndjekur edukim për zhvillim profesional në kohëzgjatje prej 40 orësh për drejtor, 20 orë për punëtor profesionist bashkëpunëtor profesionist dhe edukator dhe 10 orë për përkëdhelës.

(2) Për ripërtëritjen e licencës për punë parashtrohet kërkesë te Komisioni për Licencim nga neni 175 i këtij ligji së paku tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së licencës për punë.

(3) Ndaj kërkesës për ripërtëritje të licencës për punë të paragrafit (2) të këtij neni, parashtrohen dëshmitë nga neni 177-a paragrafi (2) alinetë 3, 4, 5 dhe 6 të këtij ligji, kopje të licencës së lëshuar paraprakisht, dëshmi për edukimin e zbatuar për zhvillim profesional (certifikata, vërtetime për trajnime të ndjekura, seminare, konferenca, simpoziume etj.)nga sfera e zhvillimit të hershëm fëmijëror në periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar dhe dëshmi të kompensimit të paguar për shpenzimet për ripërtëritje të licencës për punë.

(4) Komisioni për Licencim kontrollin e edukimit të zbatuar për zhvillim profesional e kryen përmes evakuimit të dokumenteve nga paragrafi (3) i këtij neni dhe konstaton nëse kandidati me dëshmitë e dorëzuara e ka siguruar numrin e nevojshëm të orëve të edukimit.

(5) Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga paragrafi (3) i këtij neni, dhe kontrollit të kryer për edukimin e zbatuar, Komisioni për Licencim pasi të përcaktojë se janë plotësuar kushtet për ripërtëritjen e licencës për punë dorëzon propozim te ministri për lëshimin e licencës së re për punë .

(6) Licenca për punë nga paragrafi (5) i këtij neni është për periudhë prej pesë vjetësh.”.

Neni 81

Pas nenit 179 shtohet nen i ri 179-a, si vijon:

„Neni 179-a

(1) Vazhdimi i licencës për punë ka të bëjë me personat të cilët janë pajisur me licencë për punë nga neni 178 paragrafi (1) të këtij ligji dhe të cilët në periudhën e vlefshmërisë së licencës për punë nuk kanë ndjekur edukim për zhvillim profesional në kohëzgjatje prej 40 orësh për drejtor, 20 orë për punëtor profesionist, bashkëpunëtor profesionist dhe edukator dhe 10 orë për përkëdhelës në pajtim me Programin për punë të Komisionit për Licencim.

(2) Për vazhdimin e licencës për punë parashtrohet kërkesë te Komisioni për Licencim së paku tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së licencës për punë.

(3) Me kërkesën për vazhdimin e licencës për punë parashtrohen dëshmitë nga neni 177-a paragrafi (2) alinetë 3,4,5 dhe 6 të këtij ligji, kopje të licencës së dhënë paraprake dhe dëshmi për kompensim të paguar për shpenzimet për vazhdim të licencës për punë.

(4) Licenca për punë e personave nga paragrafi (1) i këtij neni mund të vazhdohet nga Komisioni për Licencim për vërtetim të dhënë për vazhdim të licencës ekzistuese/të vlefshme për punë për periudhë prej nëntë muajsh, periudhë në të cilën Komisioni për Licencim në pajtim me Programin për punë të Komisionit për Licencim sigurohen edhe trajnimet e nevojshme për zhvillim profesional.

(5) Për trajnimin e zbatuar për zhvillim profesional mbahet evidencë për prani dhe lëshohet vërtetim për trajnim të zbatuar për zhvillim profesional që e nënshkruan kryetari i Komisionit për Licencim.

(6) Personit i cili është gjashtë muaj para pensionimit në pajtim me ligjin i vazhdohet licenca për punë për gjashtë muajt e ardhshëm deri në pensionim nga Komisioni për Licencim me lëshimin e vërtetimit për vazhdimin e licencës ekzistuese/të vlefshme për punë.

(7) Personi i cili do të parashtrojë deklaratë me shkrim për vazhdim të marrëveshjes për punësim në pajtim me nenin 104 të Ligjit për marrëdhënie pune, ndërsa vazhdim i marrëveshjes i cili është për periudhë kohore më të gjatë se gjashtë muaj, do të duhet ta ripërtërijë licencën për punë.

(8) Personi të cilit i është vazhduar licenca për punë së paku tre muaj para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së licencës për punë, është e nevojshme të parashtrojë kërkesë për ripërtëritje të licencës për punë te Komisioni për Licencim.

(9) Me kërkesën për ripërtëritje të licencës për punë nga paragrafi (8) i këtij neni parashtrohen: Kopje e vërtetimit të lëshuar për vazhdim të licencës për punë, vërtetim për trajnim të zbatuar për zhvillim profesional dhe dëshmi për kompensim për shpenzimet për ripërtëritje të licencës për punë.

(10) Komisioni për Licencim sapo të vërtetojë se janë plotësuar kushtet për ripërtëritjen e licencës për punë dorëzon propozim te ministri për lëshim të licencës së re për punë.

(11) Licenca për punë nga paragrafi (10) i këtij neni është për periudhë prej pesë vjetësh.”.

Neni 82

Pas nenit 179-a shtohet nëntitulli i ri , si vijon: „3. Heqja e licencës për punë”.

Neni 83

Nenet 181 dhe 181-a shlyhen.

Neni 84

Në nenin 184 në paragrafët (3), (5) dhe (6) pas fjalës ”kopshte” shtohen fjalët: “dhe qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve në përbërje të kopshteve për fëmijë”.

Neni 85

Në nenin 195-a në paragrafin (1) pas alinesë 2 shtohet alineja e re 3 si vijon:

"-shtesa për arsim:

Në paragrafin (3) fjala "FPIM" zëvendësohet me fjalën"FPIMV".

Neni 86

Në nenin 226 në paragrafin (4) në alinenë 1 numri "(7)" zëvendësohet me numrin „(6)".

Në paragrafin (5), numri "(7)" zëvendësohet me numrin „(6)".

Pas paragrafit (5) shtohet paragrafi i ri (6), si vijon:

"(6) Gjobë në shumë prej 200 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të qendrës për punë sociale, nëse personi i autorizuar zyrtar nuk vendos për kërkesën në afat prej 60 ditësh përkatësisht në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 42 paragrafi (1)".

Neni 87

Neni 227 ndryshohet si vijon:

"Për kundërvajtjet e kryera në bazë të diskriminimit mbi çdo lloj baze diskriminuese do të zbatohet Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi.".

Neni 88

Në nenin 228 në paragrafin (1) në alinenë 1 fjalët: „(neni 12)" zëvendësohen me fjalët: „(neni 12 paragrafi (4))".

Në alinenë 13 pas fjalëve: "institucioni privat" shtohen fjalët: " si dhe të kopshtit për fëmijë/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve nga neni 16 paragrafët (4), (5) dhe (6)".

Në paragrafin (4) në alinenë (6) fjalët: „(neni 12)" zëvendësohen me fjalët: „(neni 12 paragrafi (2))".

Pas paragrafit (6) shtohet paragrafi i ri (7), si vijon:

"(7) Gjobë në shumë prej 100 deri 150 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të punësuar në institucion për fëmijë, nëse:

- e mban evidencën pedagogjike në kundërshtim me nenin 195,
- shfrytëzon doracakë dhe revista për fëmijë për të cilat nuk ka aktvendim për miratim dhe përdorim (neni 173).".

Neni 89

Në nenin 230-a në alinenë 1 numri "(4)" zëvendësohet me numrin "(3)".

Neni 90

Në nenin 230-d numri "(6)" zëvendësohet me numrin "(5)".

Neni 91

Në nenin 230-gj fjalët: "nga neni 177-gj paragrafi (4)" zëvendësohen me fjalët: "nga neni 177-gj paragrafi (3)".

Neni 92

Në nenet 13 paragrafi (2), 16 paragrafi (6), 17 paragrafi (1), 19 paragrafët (1) dhe (10), 30 alineja 2, 34 paragrafi (1), 75 paragrafët (1) dhe (3), 76 paragrafi (3) alineja 1, 78 paragrafët (5) dhe (6), 88 paragrafi (4), 102 paragrafi (4), 104 paragrafi (4) alineja 1, 105 paragrafët (4), (9) dhe (10), 112 paragrafi (2), 120 paragrafi (11), 142 paragrafi (1) alineja 1, 177-gj paragrafi (5), 177-j paragrafi (8), 183 paragrafi (1), 184 paragrafi (3), 192 paragrafi (1), 197 paragrafi (2) dhe 206 paragrafi (1) alineja 1, fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë se Veriut".

Neni 93

Procedurat e filluara sipas kërkesave për realizimin, përkatësisht vazhdimin e të drejtës për shtesë fëmijërore, shtesë të veçantë, shtesë prindërore për fëmijë, si dhe për realizimin e të drejtës për ndihmë financiare të njëhershme për fëmijë të porsalindur të parashtruara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji dhe të cilat nuk janë zgjidhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundojnë në përputhje me dispozitat që kanë vlejtur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 94

Sipas të gjitha kërkesave për realizimin e të drejtës së shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë) të parashtruara në afat më së voni deri në mbushjen e tre muajve jetë në periudhën prej dhjetë muajsh duke filluar nga dita e zbatimit të këtij ligji, mund të realizohet e drejta e shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë), në pajtim me dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtën e shtesës prindërore për fëmijë të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ( "Gazeta Zyrtare" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144 / 14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18), nëse kërkuesit i plotësojnë kushtet sipas dispozitave të cilat kanë vlejtur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 95

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon të realizohet e drejta e fituar e shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë dhe të katërt) në pajtim me dispozitat të neneve 30-a dhe 30-b të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "numër 98 /2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008 dhe 107/2008), dispozitat e neneve 98 dhe 99 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "numër 83/2009) dhe dispozitat që kanë vlejtur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji në lartësi të përcaktuar me nenin 9 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ( "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër156/2009), si dhe e drejta e fituar e shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë), në pajtim me dispozitat e neneve 38 dhe 39, 39-a të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare

e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18), si dhe dispozitat e neneve 41, 42, 43, 44, 45, 47, 48, 49, 50 dhe 52, të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18) që kanë të bëjnë me të drejtën për shtesë prindërore për fëmijë në pjesën e procedurës për realizimin / vazhdimin e të drejtave dhe aktet nënligjore.

E drejta e fituar e shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë dhe të katërt) nga paragrafi 1 i këtij neni do të vazhdojë të realizohet, përkatësisht vazhdon deri në fund të periudhës së shfrytëzimit të të drejtës së realizuar, përkatësisht të vazhduar të shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë deri në përfundimin e periudhës prej dhjetë vjetësh, kurse për fëmijën e katërt dhe te shtesa e vetme prindërore deri në përfundimin e periudhës prej 15 vjetësh), në pajtim me nenin 30-a të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98 /2000, 17/ 2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008 dhe 107/2008), dispozitat e neneve 98 dhe 99 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 83/2009), dispozitat për të drejtën e shtesës prindërore për fëmijë (për fëmijën e tretë) të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18) dhe dispozitat që kanë vlejtur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji në lartësi prej 8.048 denarë për fëmijën e tretë, 11.267 denarë për fëmijën e katërt dhe 16.096 denarë për shtesën e vetme prindërore për fëmijë lartësi të cilat do të harmonizohen me rritjen e shpenzimeve të jetesës për vitin paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror për Statistikë në janar për vitin rrjedhës.

Në rast kur rritjet e shpenzimeve të jetës për vitin paraprak janë më të ulëta nga viti i fundit i harmonizimit, ose janë me parashenjë negative, nuk bëhet harmonizim i lartësisë së të drejtës së shtesës prindërore për fëmijën, përkatësisht i njëjti do të sigurohet me vitin e fundit të harmonizuar si më i favorshëm për shfrytëzuesin.

Neni 96

Qendra për punë sociale është e detyruar, sipas detyrës zyrtare të bëjë përkthim të personave që kanë fituar të drejtat sipas dispozitave për mbrojtjen e fëmijëve që kanë qenë në fuqi deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Deri në miratimin e aktvendimit për përkthim nga paragrafi 1 i këtij neni, shfrytëzuesi vazhdon ta shfrytëzojë të drejtën nga mbrojtja e fëmijëve në pajtim me dispozitat që kanë qenë në fuqi deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Të drejtat për mbrojtjen e fëmijëve të parapara me këtë ligj do të fillojnë të paguhen muajin e ardhshëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, e për muajin paraprak.

Neni 97

Qendra për punë sociale sipas detyrës zyrtare të shfrytëzuesve të shtesës së veçantë do t'u miratojë aktvendim për shfrytëzimin e të drejtës së shtesave të veçanta pa parashtruar kërkesë, në pajtim me konstatimin ekzistues për vlerësim dhe mendim të llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar nga organi profesional dhe aktvendim për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar në bazë të së cilës është fituar e drejta.

Neni 98

Të punësuarit me shkollim të lartë të përfunduar shkalla VI/1, me 180 kredi të fituara sipas SETK-së dhe me arsim të mesëm katërvjeçar- dhënës të shërbimeve publike, të cilët në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji kanë punuar në vende të punës si edukatorë/punëtorë profesionalë/përkëdhelës dhe i kanë plotësuar kushtet për vendin përkatës të punës në pajtim me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18), munden edhe më tutje ta kryejnë punën në vendin e punës në të cilin janë hasur me fillimin e zbatimit të këtij ligji. Të njëjtit do të mund ta përtërijnë/vazhdojnë licencën përkatëse të fituar për punë në pajtim me këtë ligj.

Për edukatorët me shkollim të përfunduar të lartë shkalla VI/1 nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji kanë punuar në vende pune si edukatorë për të cilat i kanë plotësuar kushtet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18), pjesa e pagës për shkallën e arsimit për nivelin përkatës në vendin e punës-edukator do të vlerësohet në shumën e pikëve si dhe për nivelin e edukatorit, nivelin e kualifikimeve VIA, 240 kredi sipas SETK-së ose shkallën e përfunduar VII/1 në pajtim me këtë ligj.

Neni 99

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

Neni 100

Autorizohet Komisioni Juridik-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekstin e spastruar të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve.

Neni 101

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".